

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7589 E diel 15 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* Ditës

Këto ditë të nxehta korriku dhe gushti do të kalojnë shpejt dhe do të jemi në shtator pas pak. Në shtator 2018, ekonomia jonë mbush pesë vjet në duar të ...
Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI

5 vjet ekonomi e papërfillur



Dje në "Deutsche Welle"

Nga ANI RUCI

Kushtet janë të qarta. Brukseli kërkon në tri drejtime kryesore, rezultate të qëndrueshme deri në qershor 2019 që të hapë me Shqipërinë negociatat ...
Vijon në faqen 22

Negociatat me BE? Shqipëria ka një detyrë të re përpara



E ngatërruan me një ushtarak në Lezhë

E bënë gabimisht njeri të Sigurimit, diplomati Kola padit Autoritetin e Dosjeve

Pas dy muajsh vjen qartësimi, por Llesh Kola bën padi: U shtrova 1 javë në spital nga zemra

Diplomati Llesh Kola është bërë protagonist i një incidenti të pakëndshëm pak javë më parë. Ai është etiketuar pa të drejtë nga institucionet shtetërore si i lidhur me Sigurimin famëkeq të diktaturës. Pas ballafaqimesh e verifikimesh të vazhdueshme, është kuptuar se bëhet fjalë për ...
Në faqet 10-11

INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQERORE: DOKUMENTET QE DUHET TE DOREZOHEN

TRANSFERIMI I PENSIONIT, SI PLOTESOHET FORMULARI

Kërkesa paraqitet në Agjencinë Lokale të Sigurimeve Shoqërore. Transferimet nga qarku në qark dhe nga zyra e postës në bankat e nivelit të dytë



(Në foto) Instituti i Sigurive Shoqërore

PREMTIMI I KRYEMINISTRIT

Rama: Pas Kukësit dhe Vlorës, do të ndërtojmë aeroport turistik në Sarandë

Në faqen 3

MINISTRI I BRENDSEHM

Xhafaj: Ky vit, zero kultivim të hashashit në zonën e Vlorës

Në faqen 4

APELI NE SHKODER

Punonjësi humbi jetën në pusetë, e ëma: Drejtësi, vdiq për një kundragaz


Në faqen 8

"RUSI 2018"

'Shkëlqen' Belgjika, merr vendin e tretë në Botëror, sot finalja e madhe

Në faqen 12

"MILOSAO"



Libri 'Psalitiko', përktimi i parë shqip ortodoks i Biblës në Librazhd

Suplement

Policia: Kejsi Hysa jepte para me fajde. Në kërkim, borxhliu i viktimës

I riu gjendet i varrosur me plumb në kokë

34-vjeçari u zhduk para 10 ditësh, arrestohet pronari i mobilierisë

Nga KLODIANA HAXHIAJ

FUSHË-KRUJË. Kejsi (Elion) Hysa, i zhdukur që prej 10 ditësh është gjetur dje i proposur pranë varrezave të fshatit Shelqet të Komunës Nikël të Fushë-Krujës, ndërsa ishte qëlluar me një plumb në kokë. 34-vjeçari



nga fshati Gjorm i Kurbinut, i cili ishte shpallur në kërkim për vrasjen e Edmond Theodorit në Sarandë më 10 korrik të vitit 2015, u denoncau i zhdukur që prej 5 korrikut nga familjarët e tij, të cilët dyshonin se e kishin vrasë. Kanë qenë banorë ..
Në faqen 7

PAKTI DETAR REAGIMET

Deklaratat për kufijtë tokësorë, Pashaj: Bëhet fjalë për mirëmbajtjen e piramidave

Pakti Shqipëri-Greqi, opozita greke presion Tsiprasit: Diplomaci sekrete

Demokracia e Re: Informoni parlamentin për negociatat me Tiranën

Opozita greke ka shtuar presionin ndaj kryeministrit Tsipras për të bërë publike çfarë është arritur deri më tani gjatë bisedimeve me Shqipërinë. Kjo kërkesë erdhi dhe nga partia kryesore opozitare në Greqi, Demokracia e Re, e cila ka shpërndarë një deklaratë përmes të cilës e quan "diplomaci sekrete" atë të kryeministrit Tsipras dhe të ministrit të Jashtëm, Kotzias për bisedimet që po bëhen me Tiranën zyrtare. Demokracia e Re përmes kësaj deklaratë ngulmon që qeveria të informojë parlamentin për marrëshjen mes dy vendeve. "Diplomacia sekrete e Tsipras dhe Kotzias ka rezultuar në dëm kombëtar me marrëshjen e Shkupit. Tani, njerëzit mësojnë të habitur për një marrëveshje të ngjashme, që po diskutohet me Shqipërinë. Ne i kërkojmë kryeministrit dhe ministrit të Jashtëm të informojnë menjëherë parlamentin për çfarë negociojnë në fshehtësi me Tiranën", thuhet në deklaratën e Demokracisë së Re. Një deklaratë e Komisionerit për Zgjerim, Johannes Hahn u komentua gjerësisht nga media greke me tone kritike pas tymnajes për ndryshimin e kufijve mes dy vendeve, për shkak të keqinterpretimit të deklaratës së eurokomisionerit.

SPECIALISTËT

Jo vetëm deti, por edhe toka është pjesë e bisedimeve me Greqinë. Këtu nuk bëhet fjalë për ndryshime të kufijve tokësorë, siç u fol pas deklaratës së komisionerit Hahn dhe kryeministrit grek, Alexis Tsipras pak ditë më parë. Bëhet fjalë për mirëmbajtjen dhe shenjave markuese të kufijve tokësorë. Kufijtë mes Shqipërisë e Greqisë janë të përcaktuara tashmë në bazë të protokollit të Firences, ndërsa shenjat dalluese të vendosura në natyrë, njihen si piramida. Ato janë objekte në natyrë në forme billoqesh guri të markuara dhe të shënuara, në njerëz atë të të cilave shkruhet Republika e Shqipërisë dhe në



Kryeministri grek, Aleksis Tsipras

DITMIR BUSHATI
Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati sqaroi se marrëveshja që po diskutohet me Greqinë ka të bëjë me kufizimin e zonave detare dhe atë të mirëmbajtjes së kufijve tokësorë për mirëmbajtjen e piramidave. Sipas Bushatit, po diskutohen këto pika pasi të dyja vendet duan që të shmangin incidentet e së shkuarës.

Ish-kryeministri "zbulon" marrëveshjen e Londrës, Greqi-Shqipëri

Berisha: Rama e Tsipras bënë pakt të fshehtë, i fali Greqisë 1200 km

Ish-kryeministri Sali Berisha u bëri dije thirrje të gjithë shqiptarëve të mos pranojnë me asnjë çmim marrëveshjen e fshehtë të Londrës mes kryeministrit Edi Rama dhe atij grek, Aleksis Tsipras. Ish-kryeministri Berisha akuzoi Ramën se me paktin me Greqinë po u fal fqinjëve 1200 km dhe fushat e gazit dhe naftës me trilionat fuçi naftë dhe metër kub gaz. "Kryeministri Tsipras zhvesh cullak Zografin e dytë! Të dashur miq, kryeministri i Greqisë, Tsipras pohon publikisht marrëveshjen e tij me Zografin e dytë për copëtim të ri të trojeve shqiptare në Londër! Në këtë marrëveshje Edvin Zogari i ka falur Greqisë një sipërfaqe prej 1200 km dhe fushat e gazit dhe naftës me trilionat fuçi naftë dhe metër kub gaz. Për të kuptuar se



çfarë përmban marrëveshja e Londrës mjafton të lexoni deklaratën e kryeministrit Tsipras pas takimit me Zografin e dytë në Londër, në të cilin ai haptas flet për arrijtjen e 'një zgjidhjeje që ka të bëjë me përcaktimin e zonës ekonomike ekskluzive, një zgjidhjeje që i jep avantazh të rëndësishme anës greke, por nuk dua të hyj në detaje', u shpreh Berisha. "Mendoj se për çdo shqiptar që e ndjen veten të

tillë, këto fjalë nuk kanë nevojë për asnjë koment. Po rikujtoj këtu se ministri i Mbrojtjes i Greqisë ka deklaruar në media se me marrëveshjen e detit me Shqipërinë zmadhohet atdheu (Greqia). Kurse kryeministri Tsipras deklaroi se zgjidhja (marrëveshja) i jep avantazh të rëndësishëm Greqisë në zonën ekskluzive ekonomike (zonën e naftës dhe gazit)", komentoi Berisha. Ai shtoi se, "Edvin Kristaj Rama, për të mbuluar aktin e shitjes dhe copëtimin të dytë për karriqen e tij të trojeve shqiptare, ankohet në Bruksel se shqiptarët po e quajnë tradhtar. Me këtë rast u bëj thirrje shqiptarëve të mos pranojnë me asnjë çmim marrëveshjen e fshehtë të Londrës 'Tsipras - Zografi i dytë' të copëtimin të trojeve shqiptare".

tjetër 'Republika e Greqisë' dhe kjo ndodh në të gjithë vijën kufitare të vendit. "News 24" pyeti profesor Myslym Pashajin, ish-drejtuuesin e Institutit Gjeografik Ushtarak të Shqipërisë në lidhje me ven-

dosjen e këtyre piramidave dhe se çfarë parashikon marrëveshja e re për to. "Piramidat, apo gurët me shenja dalluese janë të vendosura përgjatë gjithë vijës kufitare me shtetin fqinj. Në njërin anë të tyre shkruhet

'Shqipëri' në anën tjetër 'Greqi'. Ka një marrëveshje për rregullimin mirëmbajtjen e këtyre shenjave markuese të vijës kufitare dhe një dokumentacion të saktë për piramidat, por ka ardhur koha që marrëveshja të ripërcak-



Kryeministri Edi Rama dhe ai grek, Aleksis Tsipras

Samiti i NATO-s, Zeneli: Shqipëria s'duhet t'i mbushë mendjen vetes se është 'violina e parë'

Ish-ambasadori Bashkim Zeneli, i cili u ndërrua të premten nga Presidenti Ilir Meta me titullin e lartë "Mjeshtër i Madh" komentoi dhe samitin e NATO-s, ku merret pjesë edhe Shqipëria. Në një intervistë për emisionin "Kjo Javë" në "News 24" me Nisida Tufën, Zeneli pohoi se deri tani Shqipëria ka bërë detyrën dhe asgjë më shumë se kaq. "Unë nuk besoj se Shqipëria po bën më shumë se kapacitetin. Po të bëjë ato që janë për të bërë, detyrime politike, ushtarake, financiare, kemi bërë detyrën tonë. Ne jemi pjesë e NATO-s prej kaq vitesh. Kemi shprehur qëndrimin tonë, por s'kemi bërë asgjë të veçantë, vetëm detyrën. Kemi pasur 100 trupa në ndonjë nga vendet që na është kërkuar dhe nesër nisim 120, s'do të thotë se po bëjmë shumë. Nuk duhet t'i mbushim vetes mendjen se jemi 'violina e parë'. Duhet të bëjmë angazhimin tonë. Edhe NATO kërkon luftë kundër korrupsionit, kundër terrorizmit dhe një strategji më të qartë ndaj zhvillimeve në rajon", tha Zeneli. Mes të tjerash, Zeneli komentoi edhe deklaratat dhe kundërpërgjigjet mes Trump dhe Merkel. "Duhet parë se mes dy vendeve ka mirëkuptim historik dhe ka një raport disi të ftohtë sot në këto marrëdhënie. Kjo vjen nga të dyja palët, nga detyrimet e Gjermanisë në kuadër të NATO-s dhe raportet me SHBA dhe nga qëndrimet e Trump, i cili është duke theksuar me forcë forcimin e Amerikës", tha ai. Teksa u ndal tek kuotat, Zeneli u shpreh se është e rëndësishme që të zbatohet kuota 2%. "Duhet pranuar se vetë situata në BE nuk është e qetë. Me qëndrimet e shteteve të ndryshme, ndaj mjaft problemeve, ndaj kuotave, përballjeve, por edhe me probleme të tjera. Këto janë të pashmangshme dhe ndikojnë edhe në raportet në NATO. Është një kuota e 2%, që duhet të respektohet për secilin shtet", pohoi ish-ambasadori.



tohet në mënyrë që piramidat të mirëmbahen", tha profesor Pashaj. Më herët edhe ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, sqaroi se marrëveshja që po diskutohet me Greqinë ka të bëjë me kufiz-

imin e zonave detare dhe atë të mirëmbajtjes së kufijve tokësorë për mirëmbajtjen e piramidave. Sipas Bushatit, po diskutohen këto pika, pasi të dyja vendet duan që të shmangin incidentet e së shkuarës.



Kryeministri përruron nisjen e punimeve për 'Bypass'-in e Tepelenës

Edi Rama: Pas Kukësit e Vlorës, do të ndërtojmë aeroport turistik në Sarandë

"Qeveria e mëparshme i la të gjitha rrugët, rrugëve"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama lajmëroi dje se pas aeroportit të Vlorës, një tjetër aeroport do të ndërtohet në Sarandë vetëm për arsye turistike. Ndërsa mori pjesë në inaugurimin e nisjes së punimeve për 'Bypass'-in e Tepelenës, ai u shpreh se projekti i ri në infrastrukturë do të transformojë jo vetëm qytetin e Tepelenës, por të gjithë zonën. "Sot finalizojmë një punë të nisur prej disa kohësh. Më parë askush nuk ndalonte në Tepelenë, të gjithë donin të iknin. Kjo vepër e premtuar për dekada të tëra. Ka pasur një mungesë të përgjegjshmërisë në hartimin e projekteve. Në bashkëpunim me BB, rimodeluam skemën e financimit. Në fillim të gushtit hapen ofertat dhe brenda shtatorit, në rastin më të keq, në tetor nis puna në 'Bypass'-in e Fierit, ai i Vlorës do të marrë edhe pak më shumë kohë. Ka nisur puna në ditët e shkuara për 'Bypass'-in e Milotit. 'Bypass'-i e Tepelenës ka një plan që e parashikonte. Sot jemi në kushtet kur projekti është realizuar, ku vrima e zezë ku shkarkohen të gjitha flukset do të eliminohet", deklaroi Rama. Kryeministri Rama tha se qeveria paraardhëse i la rrugët rrugëve, ndërsa duke u ndalur tek autostrada Tiranë-Elbasan theksoi se pasojat e inaugurimit për fushatë po i vuajmë tani. "Qeveria paraardhëse mori përsipër të gjitha rrugët dhe të gjitha i la rrugëve. Rruga Tiranë-Elbasan u hap me një tunel një kalim me bujë dhe më pas u ekspozua ndaj shembjeve, duke na vënë në detyrim të bënim komplet projektin gjeologjik, një gjë e pabesueshme jo për një shtet, por edhe për një familje", u shpreh Rama. E ndërsa pritet të hapet aeroporti i Kukësit dhe të fillojnë punimet për atë të Vlorës, Rama u shpreh se ka nisur procesin për të bërë vlerësimet për të ndërtoar edhe aeroportin turistik të Sarandës. "Jemi në proces për finalizimin për të çelur aeroportin e Kukësit, jemi në proces për të ndërtoar aeroportin e Vlorës dhe kemi nisur procesin për të bërë të gjitha vlerësimet e



Kryeministri Edi Rama

DEKLARATA

"Ne duam dhe do të ndërtojmë akse kombëtare me standarde europiane. Ne nuk do të lejojmë që paratë e taksapaguesve, energjitë e shpenzuara dhe koha kaq gjatë e shpenzuar për të pasur infrastrukturë dinjitoze, të shkojnë dëm, siç kanë shkuar deri dje dhe të ngarkojnë me borxhe të pamerituara qytetarët tanë", theksoi dje në Tepelenë Rama.

AMBASADORJA FRANCEZE

"Populli shqiptar ka luftuar me gjithë forcën e tij për të shmangur ndarjen nga Evropa. Puna për Shqipërinë sapo ka filluar dhe muajt e ardhshëm do të jenë vendimtarë, ose ndryshe takimi në qershorin e ardhshëm do të priset. Barra i bie klasës politike, shumicës dhe opozitës, ka të bëjë me të gjithë", tha Christina Vasak. Çdo qytetar shqiptar e meriton Evropën, u shpreh diplomatja franceze.

Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka merr pjesë në paradën ushtarake në Paris

Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka mori pjesë në paradën ushtarake të organizuar në Paris me rastin e 14 Korrikut, festës kombëtare të Francës. Me ftesë të presidentit Emanuel Macron, ministria Xhaçka bashkë me përfaqësues të lartë të shumë shteteve ndoqi paradën ushtarake më të vjetër në botë, e cila sipas traditës mbahet në Champs Elysees. Ministria e Mbrojtjes udhëtoi drejt Parisit, pas Ministerialit të Kartës së Adriatikut që u mbajt në Kroaci dhe Samitit të NATO-s në Bruksel. Në të dy këto takime të rëndësishme u vlerësua kontributi i Shqipërisë në misionet paqeruajtëse dhe operacionet e mbrojtjes kolektive të NATO-s. Aktualisht vendi ynë shpenzon për mbrojtjen 1.2% të Prodhimit të Brendshëm Bruto, ndërsa synimi i Qeverisë shqiptare është që deri në vitin 2024 ky buxhet të shkojë në 2%. Përpis buxhetit dedikuar mbrojtjes, Shqipëria përmes kontributit me Forcat e Armatosura në misionet e NATO-s renditet si forca e dytë me kontributin më të madh si përqindje e Forcës së saj të Armatosur, në Afganistan, misionin kryesor të Aleancës dhe e 13-a ndër 29 anëtarët për kontributin e saj në misionet e tjera të përbashkëta të Aleancës.

Vasili: DASH paralajmëroi pastrimin masiv të parave, kullat prova e qartë

Kreu i grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili, tha dje se Departamenti Amerikan i Shtetit ka paralajmëruar vetëm disa javë më parë për pastrimin masiv të parave dhe kullat që po ndërtohen në Tiranë janë prova e qartë për inkriminimin e qeverisë. Sipas kreut të grupit parlamentar të LSI-së, "DASH konfirmoi se Shqipëria është nën vëzhgim të rreptë për pastrimin e parave si dhe vuri gishtin edhe në format e këtij pastrimi. Dhjetëra kullat në Tiranë janë prova e qartë, që fajëson pa asnjë ekuivok qeverinë e inkriminuar në këtë fenomen shkatërrimtar për ekonominë e vendit dhe për kriminalizimin e jetës politike dhe shoqërore të tij". "Moskonfiskimi i aseteve të veprimtarisë kriminale dhe përkundraz shëndërimi nga qeveria i Shqipërisë në një parajsë dhe lavatriçe kolosale të pastrimit të parave janë në sytë e të gjithë shqiptarëve, por edhe të partnerëve ndërkombëtare, që po ndjekin hap pas hapi me të gjitha instrumentet situatën", u shpreh Vasili. Departamenti Amerikan i Shtetit theksoi: "Institucionet shqiptare nuk janë efektive në luftën kundër pastrimit të parave. Si rezultat, paratë e pista në vend pastrohen lehtësisht. Qeveria tashmë është vendosur qartazi kundër SHBA-s dhe kundër gjithçkaje që DASH kërkoi me forcë kundër pastrimit të parave që shkatërrojnë vendin", theksoi Vasili.

Fatos Nano shfaqet në krah të Ali Ahmetit e Sabit Brokajt

"S'jam larguar nga politika, por nuk i rikthehem politikës së kulisave"

Pasi përfundoi shkrepjet me njerëzit që kërkojnë gjithmonë një fotografi me të, "Ora Neës" e pyeti nëse mund të rikthehej ndonjëherë sërish në politikë. Nano tha se këto aktivitete janë dëshmi që ai nuk e ka lënë ndonjëherë politikën, por vetëm kaq, sepse siguroi se politikës aktive të kulisave të Tiranës nuk do t'i rikthehet. Ish-kryeministri Fatos Nano aktualisht jep kontributin e tij edhe pranë një firme lobimi politik të quajtur "Alber and Geiger", duke përfaqësuar interesat e klientëve në nivelet më të larta të lidhshpirtit të Bashkimit Europian. **Është folur shumë për rikthime të mundshme në politikë, për një përmirësim të raporteve**



Fatos Nano me Ali Ahmetin e Sabit Brokajt

me kryeministrin, t'i lëmë thashethemet, na jepni dot një përgjigje si është e vërteta?

Përgjigjet janë këtu në mes të njerëzve.

Mendoni se jeni ende simpantik në radhët e njerëzve? Pse, nuk e dini ju këtë? Jo, nuk e di, po ju pyes juve?

Ja kam gjysmë orë që bëj selfie.

Rikthim i mundshëm?

Unë nuk jam larguar nga politika dhe kjo është një pjesë e veprimtarisë sime.

Po në politikën aktive?

Në atë që bëhet prapa kulisave jo, të tjerat si ju dukem me shëndet, mirë?

nevojshme për të ndërtoar edhe aeroportin turistik të Sarandës. Do të jetë një shërbim i shpejtë për të gjithë banorët e zonës. Janë edhe të tjera projekte në këtë qark, do të ndërtohet rruga që lidh Tepelenën me bregdetin, do ta kthejmë në realitet në këtë mandat. Ne nuk bëjmë inaugurime dhe nuk u bëmë daulleve elektroale dhe të ikim nga sytë

këmbët. Puna nuk do të ndalet deri në përfundimin me standarde të kësaj nyje. Do të ndërtojmë akse kombëtare me standarde", tha Rama. Ndërsa ministri i Infrastrukturës, Damian Gjoknuri tha se investimet janë përqendruar në zona me impakt ekonomik, ndërsa paralajmëroi më shumë kontrolle për zbatimin e pro-

jekteve infrastrukturore. "Një reformë të plotë në këtë autoritet për menaxhimin e plotë të projekteve, supervizionin e projekteve, menaxhimin e Partneritetit Publik Privat", u shpreh Gjoknuri. Vlera e investimit për "Bypass"-in e Tepelenës është 2.87 mlrd lekë dhe projekti parashikohet të përfundojë brenda dy viteve.

Partia Demokratike ka nisur punën për të çuar në Gjykatën Kushtetuese ligjin për teatrin. Juristët e PD-së tashmë kanë nisur punën për të përgatitur ankimumin e ligjit për Teatrin e ri Kombëtar në Gjykatën Kushtetuese. Në këndvështrimin e opozitës, vendimi i parlamentit i datës 5 korrik ka dy probleme themelore në raport me Kushtetutën. Së pari, ky ligj është hartuar për një subjekt të vetëm, kompaninë "Fusha", në një kohë që ligji është norme për një numër të papërcaktuar subjektësh. Së dyti, me këtë ligj i janë marrë kompetencat pushtetit vendor. Tjetërsimi i pronës mund të bëhet vetëm me vendim të Këshillit Bashkiak me 3/5 e votave. Par-

Ish-ministri Bardhi: Rama e Veliqaj e hoqën nga qendra historike

"Teatri", PD bën gati ankimumin në Kushtetuese: Meta të mos e dekretojë

DOKUMENTET

Dokumentet e publikuara nga PD, sipas saj provojnë se qëllimi i Edi Ramës dhe Erion Veliqajt nuk është ndërtimi i Teatrit të ri Kombëtar, por falja e pronës publike kompanisë "Fusha" sh.p.k., me synimin e vetëm të përfitimit korruptiv të rreth 205 milionë eurove.

lamenti nuk mund të marrë kompetencat e Këshillit Bashkiak me një ligj që kërkon shumicë të thjeshtë kur të drejta e pushtetit vendor janë përcaktuar nga një ligj me 84 vota. Sipas PD-së, ky ligj shkel autonominë

e pushtetit lokal që mbrohet nga Kushtetuta, ndërsa një tjetër aspekt që PD do ta përdorë si argument për të goditur shembjen e Teatrit Kombëtar është fakti që ligji për pronat shtetërore ndalon tjetërsimin e pronës pub-

like dhe kompleksët me rendësi kulturore quhen pronë publike. Po dje, PD ka akuzuar qeverinë se qëllimisht ka nxjerrë Teatrin Kombëtar jashtë ansambllit të monumenteve të kulturës, për t'i krijuar mundësi ndërtimit të kullave në këtë zonë. Ish-ministri i Drejtësisë, Gazmend Bardhi ka publikuar dy vendime të qeverisë, i pari i përket vitit 2000 dhe mbron teatrin si monument kulture; vendimi i dytë është marrë nga qeveria Rama vjet në prill dhe lë jashtë ansambllit pikërisht



Ish-ministri i Drejtësisë, Gazmend Bardhi

ndërtesën e teatrit. "Me vendimin e datës 12 prill, 2017 qeveria hoqi prej hartës së mbrojtur zonën e Teatrit Kombëtar dhe çdo zonë tjetër të Tiranës, ku ka planifikuar ndërtimin e Kullave. Vendimi për zvogëlimin Qendrës Historike është marrë pa pasur asnjë argument ligjor; teknik apo historik. Argumenti i

vetëm është pastrimi i parave dhe fitimi i miliona eurove nga Edi Rama, njësoj siç bëri kur ishte kryetar bashkie, që shndërroi çdo lulishte dhe hapësirë publike në shesh ndërtimi për të përfituar 20%-shin nga çdo ndërtim", tha Bardhi. Bardhi i bëri thirrje presidentit të mos e dekretojë ligjin.

Raporti i antidrogës italiane, Strazimiri: "Fatmirë" e "Saimirë" të narko-qeverisë, dorëzohuni

Darina Tanushi

Opozita renditi dje 9 fakte që rrëzojnë pretendimet e qeverisë për uljen e kultivimit të kanabisit në Shqipëri. Duke i referuar raportit të antidrogës italiane, deputeti i Partisë Demokratike, Gent Strazimiri tha dje se autoritetet italiane deklarohen se kanabis i kapur gjatë vitit të shkruar nuk është më i vjetër se 6 muaj, duke rrezuar kështu sipas tij, pretendimin e qeverisë se fenomeni i kultivimit është asgjësuar. "Sipas narko-qeverisë, cildo që nuk e lexon raportin e antidrogës italiane siç do Saimiri i radhës i Ministrisë së Brendshme, e bën qëllimisht e për përfitime të ulëta politike, përfshirë këtu "Zërin e Amerikës", u shpreh Strazimiri. Por, ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj i ndodhur dje në Vlorë ku pa nga afër masat për sezonin turistik akuzoi opozitën për shpifje. Ai tha se opozita ka zgjedhur të shpifë, duke shtuar se të gjithë treguesit e sigurisë janë përmirësuar. I pyetur për çështjen e kanabisit, Xhafaj tha: "Ka rezultate të pakrahasueshme me vitin e kaluar, që ka qenë një vit i jashtëzakonshëm nga ky këndvështrim. Ky do të jetë viti gati-gati i kultivimit zero të Kanabisit në territorin e Vlorës". Por megjë kjo deklarata vjen në një kohë kur opozita po hedh çdo ditë akuzat pa publikim të raportit të policisë italiane, ministri i kërkoi kësaj pjesë të politikës të jetë më e përgjegjshme kur hedh balte mbi vendin. "Motoja që ka sot opozita 'Shpif, shpif se diçka do të mbetet', mendoj që është zgjidhja më e gabuar që ka bërë dhe në funksion dhe në mungesë të një alternative serioze dhe të besueshme, por që është edhe një dëm i jashtëzakonshëm që i bëhet imazhit të vendit", - tha Xhafaj.

Droga, PD: E kapur në 6 muajt e fundit. Xhafaj: Opozita shpif

Ministri i Brendshëm: Treguesit e sigurisë janë



Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj

FATMIR XHAFAJ

"Motoja që ka sot opozita 'Shpif, shpif se diçka do të mbetet' mendoj që është zgjidhja më e gabuar që ka bërë dhe në funksion, dhe në mungesë të një alternative serioze dhe të besueshme, por që është edhe një dëm i jashtëzakonshëm që i bëhet imazhit të vendit", - tha Xhafaj.

Vlorës", u shpreh Xhafaj. Duke folur për masat gjatë sezonit, Xhafaj tha se nuk mjaftojnë vetëm kullat e vrojtitim, por edhe njerëz të përgatitur.

DEPUTETI

Nga ana e tij, deputeti i PD-së, Gent Strazimiri tha se, "përsa i përket zhdukjes së kultivimit të drogës gjatë 2017", gjenerali italian i Guardia di Finanza, Nikola Altieri i deklaroi gazetës "Liberation" para 2 javësh: "Megjithatë ata (autoritetet shqiptare) pretendojnë se droga që ende vazhdojmë të

kapim është prodhim i viteve të mëparshme, analizat e bëra mallit tregojnë se nuk është prodhim më i vjetër se 16 muajve më parë". Kjo është e vërteta, sa ç'është e vërtetë që Agron Xhafaj është trafikant droge që po kryen dënimin në Itali e që vëllain ia bënë 'Saimir' të Ministrisë së Brendshme, pasi 'reformoi' drejtësinë shqiptare". "Nëse cildo që na rrethon, paska filluar të flasë 'SHQUP', 'Fatmirë' e 'Saimirë' të narko-qeverisë dorëzohuni, koha juaj ka mbaruar! Jeni të rrethuar!",



Deputeti i PD-së, Gent Strazimiri

GENT STRAZIMIRI

"Nëse cildo që na rrethon, paska filluar të flasë 'SHQUP', 'Fatmirë' e 'Saimirë' të narko-qeverisë dorëzohuni, koha juaj ka mbaruar! Jeni të rrethuar!", u shpreh deputeti demokrat dje, duke iu referuar të dhënave të raportit të antidrogës italiane.

u shpreh deputeti demokrat. Ai tha se, "në artikullin e datës 11 korrik 2018, sipas 'Zërit të Amerikës', raporti konstaton qartësisht se: "Shqipëria është vendi i origjinës së shumicës së sasive të marijuanës që kanë si destinacion tregjet italiane dhe evropiane". Sipas raportit, "importet e marijuanës në Itali janë rritur ndjeshëm duke arritur në vitin 2017 në një rekord të konfiskimeve, mbi 90 tonë nga rreth 41 tonë që ishin në vitin 2016". Strazimiri cit-

oi raportin duke thënë se "tendenca i konfiskimeve në Itali lidhet me kultivimin e marijuanës në Shqipëri". Raporti përmend rastin në 2017, "të konfiskimit më të madh të kryer ndonjëherë, në rajonin e Marche-ve, të barabartë me 8 tonë marijuanë, të cilat kishin si destinacion Europën Veriore". Nga të dhënat e raportit, shqiptarët zinin vendin e parë në rrjetet kriminale të huaja të narkotrafikut të përfshirë në trafikun e drogës me 25 nga 94 gjithsej.

"Ky është superkrim", Braçe i tërheq vërejtje Peleshit për tokat në Divjakë

Deputeti i PS-së, Erjon Braçe, njëherësh kreu i Komisionit të Ekonomisë ngjiri dje shqetësimin për atë që ndodh me tokat bujqësore. Përmes një postimi në faqen e tij në "Facebook", Braçe shkroi se 10 muaj më parë i ka kërkuar ministrit Niko Peleshi të ndërhynte e të verifikonte kontratat e dhënies së tokës bujqësore me qira tek biznesmenët të ndryshëm, që s'kanë lidhje me bujqësinë. "Ky është krim me supertokën bujqësore, ministër! Troç e qartë, krim! Shihe! Është toka më pjellore në vend!", - shkroi Braçe. Ai u shpreh se i ka sjellë qartë rastin e një sipërfaqjeje mbi 100 hektarë, në Sektor Ferras, njësitë Grabian, Bashkia Divjakë! "Një kontratë e ditës së fundit e qeverisë 'Berisha' për luleshtyrde, rukola e fasule, ishte nënkontraktuar për të kultivuar oriz mu aty! 10 muaj më pas, gjendja është kjo në katër fotot e para. Sig duket, në tokë nuk ka as luleshtyrde, as rukola e as fasule, madje nuk ka as oriz! Ka veç ferra! Toka pas 'kultivimit' të orizit u shkatërrua deri në këtë gjendje", u shpreh Braçe duke publikuar edhe foto.

Dokumentet që duhet të plotësojnë pensionistët për të marrë përfitimet në "qarkun e ri"

Transferimi i pensionit nga një qytet në tjetrin, ISSH: Ja formulari

Kërkesa paraqitet pranë Agjencisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore

Ornela Manjani

Për të transferuar pensionin nga një qark në tjetrin, nga një njësi në tjetër ose nga posta në bankë, pensionisti duhet të plotësojë një formular-tip. Instituti i Sigurive Shoqërore publikon formularin-tip që duhet të plotësojnë pensionistët për të marrë pensionin në vendbanimin e ri. Kërkesa për transferimin e pensionit, e dosjes së pensionit, bëhet në Agjencinë Lokale të Sigurimeve Shoqërore ku ka vendbanimin e ri pensionisti, sipas kërkesës-tip. Kërkesa paraqitet tek inspektori pritis në ALSSH. Në rastin kur kërkuesi nuk ka vendbanimin në territorin e ALSSH-së ku paraqitet kërkesa, inspektori pritis e sqaron personin e interesuar për procedurat e parashikuara në rregulloren, duke i dhënë edhe alternativë për kalimin e pagesës së pensionit në një nga bankat e nivelit të dytë. Në rastet kur personi, i cili kërkon të transferojë dosjen e pensionit nga njëri rajon në tjetrin, kërkon të përfitojë kompensimet për energjinë elektrike, apo kompensime të tjera të njohura me aktet nënligjore në fuqi, duhet të paraqesë edhe dokumentacionin që provon plotësimin e kritereve për secilin lloj të kompensimit. Më pas kërkesa paraqitet tek inspektori pritis në ALSSH, i cili kontrollon në sistemin online të regjistratit të shtetasve, nëse kërkuesi ka vendbanimin në territorin ku shtrin juridiksionin ALSSH-ja. Ndërkohë, në rastin kur kërkuesi nuk ka vendbanimin në territorin e ALSSH-së ku paraqitet kërkesa, inspektori pritis e sqaron personin e interesuar për procedurat e parashikuara në rregulloren, duke i dhënë edhe alternativë për kalimin e pagesës së pensionit në një nga bankat e nivelit të dytë. Agjencia Lokale të Sigurimeve Shoqërore ku është paraqitur kërkesa për transferimin e dosjes ka detyrimin të njoftojë personin e interesuar dhe ta pajisë atë me librezën e pensionit.

KËRKESA
Kërkesa për transferimin e qendrës së pagesës kryhet brenda rrjetit të shërbimit të pagesave të Postës Shqiptare, bëhet në Agjencinë Lokale të Sigurimeve Shoqërore. Në rastin kur personi përfitues kërkon transferimin e pagesës së pensionit nga një zyrë pagesë në vartësi të Postës Shqiptare sh.a në drejtim të një dege të bankave të nivelit të dytë, zbatohen procedurat e mëposhtme: a. Kërkesa për kalimin e pagesës së pensionit dhe përfitimeve të tjera nga zyrat postare në një degë të bankave të nivelit të dytë,

DOKUMENTET QË DUHET TË DORËZOHEN PËR PËRFITIMIN E KOMPENSIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE:

1. Deklaratë për kompensimet.
2. Fotokopje e kontratës së energjisë elektrike.
3. Vërtetim për fëmijët deri në 25 vjeç nga shkolla.
4. Vërtetim nga Zyra e Tatim-Taksave të bashkisë ose komunës.
5. Vërtetim nga Zyra e punës, si punëkërkues për anëtarët e tjerë të familjes.

bëhet pranë degëve të këtyre bankave. Në këtë rast punonjësit e sporteve të degës së bankës marrin funksione të inspektorëve pritis të Agjencisë së Sigurimeve Shoqërore. b. Bazuar

në kërkesën e përfituesit, së cilës i bashkëlidhet fotokopja e letërnjoftimit elektronik e nënshkruar nga pensionisti dhe librezja e pensionit, në prezencë të përfituesit dhe të personit të

autorizuar prej tij, i cili është edhe në rolin e garantorit të marrëdhënieve financiare të pensionistit me bankën dhe DRSSH-në, dega e bankës harton kontratën përkatëse dhe çel numrin e

llogarisë së pensionistit. c. Kërkesat e pensionisteve, së bashku me kontratën, ku është evidentuar numri i llogarisë, i përcillen Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, e cila gjen-

det në të njëjtin qark me vendndodhjen e degës së bankës. **MBYLLJA E PENSIONIT**
Për rastet kur pensionisti ndërrohet jetë, duhen ndjekur një sërë procedurash për mbylljen e pensionit. Është përcaktuar mbyllja e pensionit edhe pa certifikatë të personit, por nëpërmjet informacionit të marrë nga të dhënat për vdekjet. Instituti i Sigurimeve Shoqërore, me shkresë dhe akte të veçanta të drejtorit të përgjithshëm ka udhëzuar dhe saktësuar jo vetëm procedurat që duhen ndjekur në rastin e mbylljes së pensioneve, por edhe ka analizuar e ndjekur zbatimin e këtij procesi, ndërhyrjen nëpërmjet informatikës për mbylljen e përfitimeve për persona të vdekur, bazuar në informacionin elektronik të marrë nga gjendja civile, si dhe arkëtimin e fondeve të dëmtuara në bashkëpunim me agjentët pagues si Posta Shqiptare dhe bankat.

Liçeni i Tiranës, me pista të reja dhe korsi për biçikletat

Kryebashkiaku Veliaj: Gjërat ndryshojnë kur vëmë dorë

Liçenit Artificial të Tiranës po i shtohen dita-ditës pistat e reja të vrapit dhe korsitë e biçikletave. Kryebashkiaku Erion Veliaj inspektoi punën për rigjallërimin e mëtejshëm të parkut dhe theksoi rëndësinë e vijimit të transformimit që po pëson çdo ditë qyteti i Tiranës. "Më kujtohet projekti ynë i parë të liçeni, këndi i lodrave për fëmijë. Imbah mend edhe lëvizjet, atëherë quhej 'Mos ma prek Parkun', kurse sot quhet 'Mos ma prek Teatrin', është e njëjta gjë. Pyetja është kjo: Nëse nuk i prekim gjërat me dorë, si do i ndryshojmë? Gjërat ndryshohen kur preken me dorë. As shtëpia nuk rregullohet vetë, po nuk vumë dorë. Pra, e gjithë kjo frymë rezistence ndaj ndryshimit është si fryma e atyre që vazhdojnë të përdorin telefonin e vjetër me butona, kur bota sot

TRANSFORMIMI
Kryebashkiaku Erion Veliaj inspektoi punën për rigjallërimin e mëtejshëm të parkut dhe theksoi rëndësinë e vijimit të transformimit që po pëson çdo ditë qyteti i Tiranës. "Më kujtohet projekti ynë i parë të liçeni, këndi i lodrave për fëmijë. Imbah mend edhe lëvizjet, atëherë quhej 'Mos ma prek Parkun', kurse sot quhet 'Mos ma prek Teatrin', është e njëjta gjë.

ka 'smartphone'. Ndaj, pyetja që kemi sot është: A do të vazhdojmë të modernizohemi, apo do të mbetemi peng i ca nostalgji apo ca fiksimëve?", tha Veliaj. Ai deklaroi se ndryshimet që ka pësuar Parku i Liçenit me këndin, korsitë e vrapit, librarinë dhe pyllëzimin janë treguesi më i mirë i ndryshimeve pozitive. "Qytetet, përfshi edhe Tiranën tonë, janë zhvilluar kur kanë ndryshuar. Të thuash s'kemi park, s'kemi teatër, s'kemi shesh, s'kemi bulevard dhe pastaj kur fillon e i bën këto, i kthehesh: Mos ma prek këtë, mos ma prek atë, është

realisht një humor i zi, që nuk bën për të qeshur. Ndaj, është shumë e rëndësishme që ta vazhdojmë transformimin e Tiranës dhe për këdo që nuk e kishte të plotë vizionin kur pa vetëm këndin e lodrave, por tani me librarinë, korsitë, pistat, pyllin orbital, besoj se na jep të drejtë kur themi se vetëm kur i prekim gjërat me dorë, mund t'i ndryshojmë. Fatim tonë nuk na e ka njeri tjetër në dorë dhe për ta bërë Shqipërinë dhe Tiranën si jashtë shtetit, e kemi vetë në dorë", u shpreh ai. Lidhur me pistën e vrapit dhe korsitë e biçikletave për qark



Kryebashkiaku Erion Veliaj gjatë inspektimit të punimeve

Liçenit Artificial të Tiranës, kryebashkiaku Veliaj theksoi se bashkia po çon me shpejtësi përpara projektin për ndërtimin e korsive të dedikuara. Si rezultat i ndërhyrjeve të vazhdueshme të Bashkisë së Tiranës për lirin e hapësirave të zëna dhe rehabilitimit të zonës, është dyfishuar sipërfaqja në dispozicion të qytetarëve për të kaluar disa çaste çlodhëse. "Sapo kaluam shirat, po rikuperojmë kohën e humbur nga moti për të ecur me shpejtësi për korsitë e reja të biçikletave. Siç e kemi parë, ka hapësirë për

të gjithë: korsitë e kuqe janë për biçikletat, korsitë e tjera për këmbësorët, ka një pjesë për ata që thjesht duan të ecin, do të ketë edhe një sinjalistikë që i respekton korsitë, por ajo që ishte e habitshme për të gjithë ne, është se sa hapësirë i kemi dhënë Liçenit. Trashëguam një Liçen që në fëmijërinë tonë ishte vetëm një copë e vogël rreth kishës së Shën Prokopit, prapa universitetit dhe krejt papritur jo vetëm që është bërë Unaza në të gjithë Liçenin, por kemi përfituar dy herë hapësirë", deklaroi Veliaj.

Qato: Konsultim të vazhdueshëm me biznesin

Riciklimi i qeseve, qeveria reflekton. Biznesit do t'i lihet kohë

Kompanitë që riciklojnë qeset plastike do të kenë në dispozicion disa muaj kohë, për të përshtatur teknologjinë e prodhimit të qeseve, që tashmë lejohet të përdoren nga subjektet tregtuese apo konsumatorët. Marrëveshja u arrit pas konsultimeve mes përfaqësuesve të qeverisë dhe biznesit. Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Sonila Qato gjatë një takimi me kompanitë e riciklimit bënë të ditur edhe marrëveshjen. Klosi tha se në zbatim të ligjit për qeset plastike është në proces hartimi i udhëzimit të ministrit për saktësimin e zbatimit të tij për disa elementë si procesi i biodegradimit,

nga inspektoratet, tatimet dhe doganat. Ministri i Mjedisit dhe Turizmit, Blendi Klosi, teksa ishte bashkë me ministrin e Sipërmarrjes, Sonila Qato gjatë një takimi me kompanitë e riciklimit bënë të ditur edhe marrëveshjen. Klosi tha se në zbatim të ligjit për qeset plastike është në proces hartimi i udhëzimit të ministrit për saktësimin e zbatimit të tij për disa elementë si procesi i biodegradimit,

riciklimit apo pjesëve të qeseve. Klosi deklaroi në tryezën e mbajtur me përfaqësues të biznesit të plastikës, se do të jenë pjesë e hartimit të këtij udhëzimi, duke iu kërkuar bashkëpunim edhe për këtë proces. "Ajo që nuk negociohet është ndalimi njëherë e përgjithmonë i përdorimit të plastikës së paricikluar në vend", deklaroi ministri Klosi. Biznesit iu la një muaj kohë në dispozicion për adaptimin e

teknologjive, për të ndaluar prodhimin e qeseve të holla njëpërdorimshme, që do të shumë se treqind vite të vetëshkatërrohet. "Një vend si Shqipëria me përparësi turizmin nuk mund të vijojë më të ndotet nga plastika", - tha Klosi në takimin me ricikluesit, duke përmendur edhe masat ndëshkuese në ligj, nga një milion deri në 1.5 milionë lekë të reja për këdo që vijon të hedhë në përdorim këtë produkt. Klosi kërkoi



bashkëpunimin e të gjithëve për të denoncuar mungesën e kontrolleve nga ana e inspektoratit në zona të caktuara, bashkëpunimin e pushtetit vendor, prodhuesve

dhe qytetarëve. "Vetëm duke u bërë bashkë në interesin e lartë të eliminimit të qeseve, do të arrijmë reduktimin e shpejtë të këtij ndotësi", - deklaroi Klosi.

Bregdeti "në sitë", Tatimet: 58% e bizneseve të verifikuara janë me shkelje

TVSH-ja te biznesi i vogël, të hënën afati i fundit për dorëzimin e deklaratës

Rreth 11 000 biznese duhet të dorëzojnë dokumentet

Ornela Manjani

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve dëshiron të sjellë në vëmendje të tatimpaguesve, që janë përfshirë për herë të parë në skemën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH-së), detyrimin për të plotësuar dhe dorëzuar deklaratën e thjeshtuar, brenda datës 16 korrik 2018. Biznesi i vogël, që hyri në skemën e TVSH-së në 1 prill, pas uljes së kufirit të TVSH-së nga 5 në 2 milionë lekë, duhet që të bëjë deklaratat e TVSH-së një herë në tre muaj. Janë rreth 11 mijë biznese, të cilat kanë detyrim dorëzimit e deklaratës. Administrata tatimore është e gatshme t'ju asistojë gjatë këtij procesi dhe për këtë qëllim ju fton të vizitoni "Këndin e Asistencës", i dedikuar për biznesin e vogël, pranë të gjitha Drejtorive Rajonale Tatimore (13 kënde efektive). Pranë këtyre këndeve ju mund të merrni të gjithë asistencën e nevojshme, në mënyrë që të përmbushni me korrektësi detyrimet ligjore. Gjithashtu, për çdo paqartësi ju mund të telefononi pranë Qendrës së Thirrjeve në numrin e gjelbër pa pagesë 0800 00 02, ku një operator do t'ju ofrojë asistencë në kohë reale: nga e hëna në të enjte ora 08:30-18:00 dhe e premte ora 08:30-16:00.

KONTROLLET

Ndërkohë, Drejtorja e Hetimit Tatimor Rajoni Qendror po ushtron kontrolle të detajuara ndaj subjekteve, që kanë veprimtari ekonomike në zonat turistike të qarkut të Durrësit dhe Korçës, përkatësisht nga Gjiri i Lalëzit në Spille dhe nga Pogradeci, në Dardhë e Voskopojë. Duke filluar nga data 22 qershor, strukturat e specializuara hetimore të kësaj drejtorie kanë verifikuar në total 680 subjekte. Nga këto, për 397 subjekte janë marrë masa me një vlerë prej rreth 12.6 mil-



Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve

ionë lekësh. Në çdo dhjetë biznese që kanë qënë subjekt kontrolli nga Tatimet, 6 kanë rezultat me shkelje. Më konkretisht "për moslëshim kuponin hera parë" janë konstatuar 101 shkelje, për "moslëshim kuponin hera dytë" janë konstatuar 3 sh-

kelje, për të cilët është marrë edhe masa e bllokimit 30 ditë; për "punonjë të padeklaruar" janë konstatuar 59 shkelje; për "mall pa faturë tatimore" (rivlerësim dhe ndryshim përgjegjësie) janë konstatuar 87 shkelje, ndërsa 33 subjekte kanë rezultu-

Biznesi i vogël, që hyri në skemën e TVSH-së në 1 prill, pas uljes së kufirit të TVSH-së nga 5 në 2 milionë lekë, duhet që të bëjë deklaratat e TVSH-së një herë në tre muaj. Janë rreth 11 mijë biznese, të cilat kanë detyrim dorëzimit e deklaratës.

ar të paregjistruara në organet tatimore. Drejtorja e Hetimit Tatimor Rajoni Qendror, iu bën thirrje tatimpaguesve, të ushtrjnë aktivitetet ekonomike konform ligjit, për të siguruar më tej mbarëvajtjen e sezonit turistik.



Problemet e sigurisë ushqimore

KLSH: Kapacitete të dobëta, inspektorët pa formimin e duhur

Kontrolli i Lartë i Lartë i Shtetit arrin në konkluzion se Autoriteti Kombëtar i Ushqimit nuk ka arritur të garantojë besimin e konsumatorëve për sigurinë ushqimore në vend. Në një analizë për këtë sektor, KLSH vëren se performanca e dobët vjen për shkak se kuadri rregullator është i paplotësuar, ka mbivendosje, dublime kompetencash dhe mungesë të ndarjes së përgjegjësiive institucionale. Nuk ka funksionuar bordi, komiteti shkencor me panellet, si dhe drejtorët e përgjithshëm pas vitit 2016 janë emëruar në kundërshtim me kërkesat përkatëse ligjore. Sipas KLSH, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka shfaqur mangësi në administrimin e shërbimit civil, si dhe nuk ka një shpërndarje racionale të inspektorëve në rajone dhe sipas sektorëve brenda tyre, ka kapacitete të dobëta inspektuese si pasojë e largimeve të paligjshme, mungesës së përputhjes së kritereve të formimit profesional; mungesës së trajnimeve, testeimeve, kualifikimeve dhe për pasojë cilësi dhe numër i ulët e inspektimeve. Nga ana tjetër, në analizë vërehet se nuk janë trajtuar siç duhet masat administrative të dënimit me gjobë të subjekteve të gjendur në kundërshtim me ligjin, pajisjet laboratorike në masë të konsiderueshme janë të amortizuara e jashtë përdorimit dhe laboratorët janë të paautorizuar, mungojnë investimet në asete e infrastrukturën inspektuese, si dhe në pajisjet laboratorike me shtrirje në të gjithë vendin, të nevojshme dhe të domosdoshme për përmirësimin e sigurisë ushqimore në vend.

TREGTOHEJ ME BIDONË NË RRUGË

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit u ka konfiskuar rreth 50 litra qumësht disa shitëse ambulante në Sarandë. Sipas AKU-së, ata tregtonin qumështin me bidonë dhe në kushte të rënda higjieno-sanitare. Gjatë aksionit të përbashkët me Policinë Bashkiake, janë bllokuar saktësisht 43 litra qumësht dhe janë dër-

AKU bllokoi rreth 50 litra qumësht në Sarandë

guar për kryerjen e analizave përkatëse. Ky aksion është vijim i punës së AKU-së në funksion të sigurisë ushqimore në kuadër të përforcimit të masave përgjatë sezonit turistik. Ndërkohë, AKU deklaron se nuk do të lejohet

më tregtimi i qumështit të tillë nëpër rrugë. Ndërsa u bën thirrje konsumatorëve që të refuzojnë blerjen e produkteve të bulmetit të shitësit ambulantë, pasi ata janë të palicencuar dhe tregtojnë produkte të pasigurta.

Policia: I riu nga Laçi jepte para me fajde. Në kërkim shtetasi A.T., i kishte 8 mijë euro borxh viktimës

Gjendet i groposur e me plumb në kokë Kejsi Hysa

34-vjeçari u zhduk para 10 ditësh, arrestohet pronari i mobilierisë, Hysni Rama

Klodiana Haxhiaj

FUSHË-KRUJË

Kejsi (Elion) Hysa, i zhdukur që prej 10 ditësh është gjetur dhe i groposur pranë varrezave të fshatit Shelqet të Komunës Nikël të Fushë-Krujës, ndërsa ishte qëlluar me një plumb në kokë. 34-vjeçari nga fshati Gjorm i Kurbinit, i cili ishte shpallur në kërkim për vrasjen e Edmond Theodorit në Sarandë më 10 korrik të vitit 2015, u denoncua i zhdukur që prej 5 korrikut nga familjarët e tij, të cilët dyshonin se e kishin vrasë. Kanë qenë banorë të fshatit Shelqet, të cilët janë habitur nga një varr i ri dhe pa emër sipër. Në një kohë kur të gjithë pyesnin se kush kishte ndërruar jetë, pikërisht në këtë varr ishte varrosur i riu nga Kurbini. Pas marrjes në pyetje të banorëve, policia ka mundur të zbulojë trupin e 34-vjeçarit të zhdukur. Mësohet se pranë trupit të viktimës janë gjetur një pushkë dhe një pistoletë. Pasi u zvarros, trupi i pajetë i të riut u dërgua në morg, ku do të nënshtrrohet ekspertizës mjeko-ligjore për të vërtetuar faktin nëse ai ishte torturuar para vdekjes, ndërsa armët janë dërguar në laborator për ekzaminimin e gjurmëve. Po ashtu, ka dyshime se autorët e kanë groposur gjatë natës pranë varrezave të riut, për t'iu shmangur edhe syrit të njerëzve. Ndërkaq, burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Durrësit bënë me dije se pas hetimeve



Viktima Kejsi Hysa

DENONCIMI TE BERISHA

Më 9 korrik, ish-kryeministri Berisha publikoi denoncimin e një qytetari me identitet të plotë, që thoshte se i është zhdukur nipi që më datë 5 korrik dhe akuzon policinë se nuk ka reaguar. Qytetari thotë se djali i vëllait, Kejsi Hysa është zhdukur në zonën e Niklës, në Fushë-Krujë, duke hedhur dyshimet se edhe mund të jetë vrasë. "Zhdukët prej 5 ditësh në zonën e Niklës i riu Keisi Elion Hysa, narko-policia hesht për krimin!", shkruante Berisha në "Facebook".

të kryera është bërë i mundur identifikimi i autorëve të krimin. Sipas bluve, në praninë ka përfunduar Hysni Rama, pronar i një mobilierie, i cili kishte lënë takim me viktimën ditën që ky është zhdukur, ndërsa është shpallur në kërkim shtetasi A.T. Po të njëjtat burime pohuan se vrasja e Hysës nuk ka lidhje me ngjarjen e vitit 2015 në Sarandë. Dyshohet se ekzekutimi i tij është kryer për shkak të borxheve që njëri nga autorët i kishte vik-

timës. Banorë të zonës kanë pohuar në polici se viktima njihet ndryshe si "Tik Fajdexhiu", pasi jepte para me përgjindje. Aktualisht policia po heton rreth dy pistave, asaj të një borxhi të pashlyer, apo edhe përfshirjen në ndonjë bandë të narko-trafikut.

VRASJA

Sipas hetuesve të çështjes, Kejsi (Elion) Hysa kishte marrë një dyqan me qira në Nikël dhe në datën 5 korrik kishte lënë një takim me telefon me një person nga

Si e vranë vëllezërit Hysa pronarin e lavazhit në Sarandë, Edmond Theodorin

SARANDË - Në orët e para të mëngjesit të 10 korrikut të vitit 2015, në qytetin e Sarandës u vra me armë Edmond Theodori. Sipas policisë, ngjarja ka marrë shkas pas një shërri të ndodhur në orët e vona të mëngjesit të 8 korrikut. Blutë pohan se Gani dhe Keivi Hysa (Alias Ahmet Hysa), përkatësisht xhaxha e nip, të cilët prej disa ditësh ndodheshin për pushime në Sarandë, për shkaqe banale janë konfliktuar në rrugë me shtetasin Edmond Theodori dhe Andon Salla, të dy banues në qytetin bregdetar. Pasi konflikti është shuar me ndihmën e personave të tjerë në vendngjarje, shtetasi Kevi Hysa ka telefonuar për atë çfarë kishte ndodhur vëllain e tij, Elion Hysa (alias Eris ose Kejsi Hysa), i cili ndërkohë ndodhej në fshatin e tij, në Gjorm, Laç. Menjëherë Elioni ka vendosur t'i shkojë në ndihmë xhaxhait dhe vëllait të tij. Për t'ju ofruar ndihmën e tij, Elioni ka marrë me vete shokët (bashkëfshatarët e tij):

Ledi Hysa (alias Armir Hysa), Ylli Reçi dhe Ajman Zyba. Këta katër persona kanë udhëtuar drejt Sarandës me automjetin tip "Audi", me targe "AA 060 KH", drejtuar nga shtetasi nen hetim Ledi Hysa. Pasi kanë mbërritur në Sarandë, ata janë takuar me Ganiun e Keivin. Më pas ata kanë vendosur të përballeshin me Theodhorin, të cilin arritën ta gjenin në orët e para të mëngjesit të 10 korrikut. Pasi kanë ndarë rolet duke u vendosur në pozicione të ndryshme, është realizuar edhe vrasja e tij. Gjykata ka çmuar se Gani Hysa duhet të gjykohej për "Përkrahje të autorit të krimin" dhe u dënua me gjykim të shkurtuar me 2 vjet e 8 muaj burg. Ledi Hysa, Ylli Reçi dhe Ajman Zyba u dënuan për "moskallëzim krimi", secili nga 13 muaj burgim. Ndërkohë, vazhdon gjykimi për "vrasje me paramendim" për Keivin dhe Elion Hysën. Keivi Hysa është arrestuar në shkurt të 2018-ës në Itali. Ndërsa, Elioni, i cili ishte në kërkim u vra dhe u gropos pak ditë më parë.

ar.su.

kjo zonë që kishte një mobilier, konkretisht me shtetasin Hysni Rama. Por pas ditës së takimit, ai u zhduk pa gjurmë dhe familja nuk kishte më asnjë informacion për të. Personi në fjalë pohoi se kishte lënë takim, por 34-vjeçari nuk kishte shkuar dhe nuk ishin takuar. Pasi policia e Kurbinit ndaloi pronarin e mobilierisë dhe i vuri në përgjim telefonin, krijoi dyshime të arsyeshme se ai bashkë me një tjetër person, konkretisht shtetasin me inicialet A.T., e kishin vrasë dhe më pas e kishin varrosur 34-vjeçar në varrezat e fshatit të tyre. Pas hetimit

me metoda shkencore dhe përgjimeve të telefonatave, policia shkoi në fshatin Shelqet dhe pyeti banorët nëse kishin parë njerëz në varreza, ndërsa ata shprehën dyshimet e tyre për varrin e ri. Me urdhër të prokurorit të Krujës, policia vendosi të hapte varrin e ri, ndërsa u zbulua kështu edhe vendndodhja e të riut që ishte denoncuar i zhdukur nga familjarët.

HETIMET

Pista kryesore ku po heton policia për zbardhjen e plotë të ngjarjes është ajo e vrasjes për shkak të borxheve. Burime pranë grupit hetimor thanë se Kejsi Hysa

i kishte dhënë 8 mijë euro para me fajde, autorit të dytë të dyshuar A.T., i cili është në kërkim. Mësohet se disa ditë përpara vrasjes, Hysa ngulmonte që t'i ktheheshin paratë. Ndërsa, A.T. i ka thënë që nuk ndodhej në Nikël, por kishte shkuar tek e motra në Fier. Hysa ka shkruar në Fier me makinën e tij dhe atje është takuar me A.T., nga ku më pas kanë nisur drejt Niklës. Sapo kanë mbërritur në Nikël, 34-vjeçari dhe A.T. kanë marrë në makinë autorin tjetër të vrasjes, Hysni Ramajn. Ata më pas i janë drejtuar vendit të vrasjes, ku dhe kanë ekzekutuar Kejsi Hysën.

TIRANË - I zhveshur nga posti i ministrit të Brendshëm, në kulmin e akuzave të opozitës për lidhje me trafikantët e drogës, Saimir Tahiri zgjedh të udhëtojë me jaht luksoz nga Mali i Zi në Leçe të Italisë. Ky udhëtim i ish-ministrit nën hetim për lidhje me grupin kriminal Habilaj është zbuluar së fundmi nga grupi i prokurorëve që po heton për aktivitetin e tij, pas këqyrjes së telefonit të njërit prej personave të dyshuar, ku janë gjetur foto të Tahirit dhe personave që e shoqëronin. Burimet thanë se bëhet fjalë për verën e 2017, pak javë përpara se Prokuroria për Krime të Rënda të niste hetimin ndaj Tahirit dhe ka gjasa ta rëndojnë jo pak pozitën e tij përballë drejtësisë. Burime pranë grupit të hetimit thanë se gjatë

Fotot, nga telefoni i një prej të dyshuarve të dosjes "Habilaj"

"Aventurat" e ish-ministrit Tahiri, si udhëtoi me jaht luksoz nga Mali i Zi në Leçe të Italisë

ZGJATEN 3 MUAJ HETIMET

Prokuroria e Krimeve të Rënda ka zgjatur me tre muaj të tjerë afatet hetimore për ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri. Afatet për Tahirin përfundojnë më 17 korrik. Mësohet se kjo shtyrje e re diktohet nga pritja e letër-porosive që Prokuroria e Krimeve të Rënda ka dërguar jashtë vendit. Kjo është shtyrja e tretë tremujore e hetimeve për ish-ministrin e Brendshëm.

hetimit ka rezultuar se ish-ministri ka udhëtuar me automjet nga Shqipëria drejt Malit të Zi dhe prej andej me jaht në drejtim të Leçes. Por, grupi i hetimit kërkoi të zbulojë se kush është pronari i jahtit, me kë udhëtoi ky i

fundit nga Mali i Zi në Itali, ku u akomodua ish-ministri dhe miqtë e tij dhe kush i pagoi shpenzimet. Në fakt, kjo nuk ishte hera e parë që Saimir Tahiri udhëtonte drejt vendeve fqinje duke drejtuar mjete lundruese në

pronësi të personave të tretë. Në 2014-ën, vetëm një vit pasi kishte marrë detyrën e ministrit të Brendshëm, ai udhëtoi drejt Greqisë, me një skaf në pronësi të Orgest Liperit. Në dosjen e prokurorisë thuhet se skafi përsoi defekt dhe Saimir Tahiri kërkoi ndihmën e Artan Habilajt dhe një zyrtari policie. Të dy ata e sollën mjetin lundrues në Shqipëri. Momenti që e implikon në këtë pikë ish-ministrin, është fakti se skafi në pronësi të Liperit u dërgua në Itali nga vetë Moisi Habilaj, i dyshuar si kre i grupit kriminal e që aktu-



Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri

alish ndodhet në burg në Katania. E ndërsa prokurorët janë duke renditur të gjitha provat mbi bazën e të cilave pretendojnë të provojnë akuzat ndaj ish-ministrit dhe nuk ndalen në përpjekjet e tyre për ta çuar prapa hekurave, përmes rekursit të bërë së fundmi në Gjykatën e Lartë, Tahiri shfaqet i qetë në rrjetet sociale. Nga shëtitjet me kalë

tek rritja e bletëve, këto janë mënyrat sesi e vret kohën, njeriu që dikur konsiderohej ministri kampion, por që ndryshe nga dje, tashmë i duhet të zhvillojë betejën e jetës, siç e ka cilësuar vetë ai, përballjen me drejtësinë. Deri më tani, Saimir Tahiri i ka fituar betejat me gjykatat. Ndajësia e radhës pritet të jetë Gjykata e Lartë.

kl.la.

Sanije Çeliku: Përgjegjësit janë të lirë, çështjen do e çojmë deri në Strasburg

Punonjësi i Ujësjiellësit humbi jetën në pusetë, nëna apel kryeprokurores Marku: Duam drejtësi!

"Djali vdiq për një kundragaz, askush nuk dha ndihmë për 2 fëmijët jetimë dhe bashkëshorten"

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Familjarët e Kleotos Çelikut, i cili humbi jetën një vit më parë në Shkodër teksa po punonte në një pusetë kërkojnë drejtësi. 33-vjeçari ishte prej 18 vitesh punonjës i Ndërmarrjes së Ujësjiellësit. Pas një viti nga ajo ngjarje, nëna e tij, Sanije Çeliku dhe daja i Kleotosit, Fatos Hasaj shprehën se bashkia dhe shteti nuk kanë dhënë asnjë lloj ndihme për dy djemtë e vegjël dhe 2 vjeç si dhe bashkëshorten e tij, Elën. Prindërit e Kleotosit janë të moshuar dhe nuk mund të punojnë më, ndërsa bashkëshortja e të ndjerit duhet të mbajë dy djemtë e vegjël. Familja e Kleotosit jeton në fshatin Golem të njësisë Rrethina në Shkodër. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", nëna e 33-vjeçarit pohoi se djalin e çoi shëndosh në punë dhe ia sollën të vdekur. "Një kundragaz të kish-te pasur Kleotosi, ai do ishte gjallë sot, më thoni sa kushton një kundragaz? Kërkojmë nga vetingu, kërkojmë nga kryeprokuroria Artë Marku dhe nga kushtodjtëjtë që të vendosin drejtësinë në vend. Kemi pritur një vit dhe tashmë s'do ndalemi, madje çështjen do e çojmë deri në Gjykatën e Strasburgut", u shpreh 60-vjeçarja.



33-vjeçari Kleotos Çeliku



Sanije Çeliku, duke folur për "GSH"

Ngjarja më 14 korrik të 2017-ës, rrezikoi jetën edhe kolegu

33-vjeçari Kleotos Çeliku shkoi të zhbllokonte pusetën e ujërave të zeza, u asfiksua nga gazi toksik

A kemi marrë ndonjë sqarim për çfarë ka ndodhur?

Nuk më ka dhënë kush asnjë sqarim për vdekjen e djalit tim, Kleotosit, i cili humbi jetën teksa ishte duke punuar në një pusetë si punonjës i Ndërmarrjes së Ujësjiellësit-Kanalizime Shkodër. Nuk ka asnjë lloj ndihme dhe asnjë lloj gjëje nga askush. Unë di vetëm që më ka ardhur djali i vdekur. E kam çuar shëndosh në punë dhe më ka ardhur i vdekur. Jo vetëm që s'më kanë dhënë asnjë lloj ndihme, por të paktën asnjë kurorë më lule nuk e ka sjellë Bashkia Shkodër pas vdekjes së Kleotosit.

Prej sa kohësh punonte Kleotosi tek Ujësjiellësi?

Unë e kam futur djalin në punë që kur ai ishte 15 vjeç. Punonte atje kur ishte krejt i vogël dhe është rritur aty, duke qenë shumë korrekt në çdo gjë.

A ju ka thirrur prokuroria ose ndonjë organ tjetër?

As nuk më ka thirrur prokuroria, as në gjykatë nuk kam thirrur asnjëherë dhe askund tjetër s'më kanë thirrur. Të gjithë janë të lirë, ndërsa djali im është i vdekur dhe ende nuk kemi të qartë për atë ngjarje.

Kush duhet të mbajë përgjegjësi për atë që ka ndodhur?

Gjithkush duhet që të mbajë përgjegjësi dhe veta, sepse djali im ka vdekur për shkak se nuk ka pasur mjete e sigurisë dhe sikur t'i kishte pasur ato, ai do të kishte qenë gjallë sot.

A është zbardhur ajo që ka ndodhur?

Jo, nuk është zbardhur asgjë. Përkundrazi, njëzëri të

SHKODËR - Më 14 korrik të vitit që shkoi, Kleotos Çeliku kishte dalë nga shtëpia e tij si çdo ditë për të shkuar në punë. Mësohet se kur ka shkuar tek Ndërmarrja e Ujësjiellësit-Kanalizime ku punonte prej 18 vitesh, i është thënë që atë ditë duhej të shkonte për të zhbllokuar një pusetë të ujërave të zeza në lagjen "Rus" të Shkodrës. Kleotosi u nis atje për të mos u kthyer më i gjallë. Ai u fut në pusetë, por menjëherë u asfiksua nga gazi toksik që gjendej brenda. Kleotosi gjeti vdekjen e menjëhershme, ndërsa një kolegu i tij shpëtoi sepse e nxorën në kohë nga puseta, ndërsa edhe ai rrezikoi



jetën. Në vendngjarje përveç ambulancës mbërriti policia, prokuroria dhe Inspektorati i Punës për të nisur hetimet. Nisi një hetim për atë ngjarje, ndërsa u bë edhe ekspertiza, që sipas familjarëve rezultoi se shkaku i vdekjes është nga mungesa e kushteve të punës, duke qenë se

Kleotosit nuk i ishin dhënë mjete dhe duhura. Nga hetimet deri më tani ende nuk është zbardhur e plotë ajo që ka ndodhur. Pas ngjarjes pati edhe disa protesta në Shkodër nga Shoqëria Civile, që kërkonin drejtësi për jetën e humbur të Kleotos Çelikut.

DAJA I VIKTIMËS

Fatos Hasaj, daja i Kleotos Çelikut deklaroi se ka bërë disa përpjekje për të kërkuar ndihmë, por deri më tani nuk ia ka arritur. Një gjysmë pensioni prej 126 mijë lekësh të vjetër është krejt i pamjaftueshëm për familjen e Kleotosit, e cila jeton me vështirësi ekonomike. Ndërkaq, Hasaj tha se drejtësia duhet të bëjë punën e saj dhe se institucionet duhet t'i vijnë në ndihmë familjes së Kleotosit, e cila prej një viti është lënë në harresë.



Çfarë kërkoni ju?

Unë dua drejtësi dhe dua të gjitha të drejtat për djalin tim. Ai ka qenë punonjësi më i mirë. Ka qenë shumë i rregullt, ndërsa ka paguar edhe të gjitha sigurimet që nga koha kur ka nisur punën, 15 vjeç dhe deri kur u nda nga jeta në moshën 33-vjeçare. Shteti duhet të na përgjigjet edhe për vazhdimësinë. Kërkojmë nga vetingu, kërkojmë nga kryeprokuroria Artë Marku dhe nga kushtodjtëjtë që të vendosin drejtësinë në vend. Kemi pritur një vit dhe tashmë s'do ndalemi, madje çështjen do e çojmë deri në Gjykatën e Strasburgut.

SHKURT

Tentuan të kalojnë 15 emigrantë në Mal të Zi, pranga 4 tiranasve

SHKODËR - Katër persona janë arrestuar nga policia e Shkodrës për dhënie ndihme të kalimit të paligjshëm të kufirit. Sipas bluve, gjatë operacionit të koduar "Wrong Way" u arrestuan shtetasit: Bashkim Alijaj, 35 vjeç, banues në Tiranë; Halil Hafuzi, 43 vjeç, banues në Shkozë, Tiranë; Gentjan Boçku, 43 vjeç, banues në Bathore, Tiranë dhe Adem Cela, 32 vjeç, banues në Bathore, Tiranë. Arrestimi i tyre u bë, pasi në lagjen "Bahçallëk" u kapën duke transportuar 15 shtetas të huaj të vendeve të treta, me qëllim kalimin e tyre nga Shqipëria drejt Malit të Zi, e më pas destinacion final kishin vendet e BE-së.

I mori rryshfet qytetarit, arrestohet efektiv i policisë

TIRANË - Një punonjës policie është arrestuar për korruption në Tiranë. Efektiv i Emiljano Taku ra në pranga, pasi dyshohet se i kërkoi një shumë parash prej 2 mijë lekësh një qytetari, në këmbim të shmangies së masës administrative. "Denoncimi për këtë rast erdhi nga vetë qytetari e më numrin e gjelbër të SHCBA 0800 90 90. Menjëherë pas marrjes së denoncimit SHCBA ka identifikuar punonjësin e policisë në Bulevardin Blu", në Kamëz dhe e arrestuar atë", bën me dije policia.

Dosjet e viteve 1993-2008, formulari-tip për informim në lidhje me ecurinë e vendimeve

Ornela Manjani

Pronarët në Korçë, ATP merr në shqyrtim 10 mijë dosje

Problematikat, procedurat për t'u njohur me ecurinë e shqyrtimit

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 10 mijë dosje ish-pronarësh, që janë në proces shqyrtimi nga kjo agjenci. Kërkesit janë në qarkun e Korçës. Në listën e përditësuar jepet numri i dosjes dhe data e aplikimit, gjeneralitetet e kërkuarit, sipërfaqet e njohura për kompensim, dosjet për pronarët që kanë marrë vendim negativ dhe dosjet që duhet të plotësohen. Dosjet janë të viteve 1993 deri në vitin 2008. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vënë në dispozicionin të pronarëve formularin-tip, "Informacion në lidhje me ecurinë e dosjes", i cili duhet të plotësohet dhe të dorëzohet në Agjencinë për t'u njohur me fazën në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj. Agjencia Trajtimit të Pronave është e detyruar që brenda 15 ditëve nga momenti i dorëzimit të kërkesës t'i kthejë përgjigje pronarit në lidhje me ecurinë e dosjes.

FORMULARI

Formulari i aplikimit për informacion në lidhje me ecurinë e dosjes është i ndarë në tri seksione. Aplikanti duhet të plotësojë gjen-

eralitet, adresën dhe të jetë i pajisur me mjet identifikimi në momentin e aplikimit. Në seksionin e dytë duhet të jetë përshkruar në mënyrë të saktë se në lidhje me çfarë kërkon informacion pala e interesuar, në këtë rast pronari që ka aplikuar për kthim e kompensim prone. Dhe në seksionin e fundit janë të specifikuar pesë dokumentet që duhet të disponojë pronari në momentin e aplikimit.

APLIKIMI

Për t'u njohur me ecurinë e dosjes, subjekti duhet të dorëzojë dhe të paraqesë dorazi ose me postë pranë ATP-së kërkesën përkatëse me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes, fotokopje të kartës së identitetit, dëshmi trashëgimie

DOKUMENTACIONI QË DUHET TË PARAQISNI

- Formulari-tip
- Fotokopje e kartës së identitetit
- Kopje vendimi nga ish-KKP/AKKP (nëse ka)
- Dokumente të tjera

dhe prokurë të posaçme. Në fazën zyrtare të ATP-së mësohet se subjekti plotëson kërkesën me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, në Agjencinë. Më pas, kërkesa i kalon zyrës së protokollit, e cila pasi e protokollon, ia dërgon të gjitha kërkesat e ardhura drejtorit të përgjithshëm. Kreu i AKKP-ës ia delegon kërkesat sek-

torit përkatës për ndjekje dhe zbatim. Më pas, sektori përkatës përgatit informacionin e kërkuar dhe njofton subjektin. Në përfundim të shqyrtimit, subjekti paraqitet pranë zyrave të ATP-së për të tërhequr shkresën e kthimit të përgjigjes në lidhje me ecurinë e dosjes ose i dërgohet me postë, sipas kërkesës. Aplikimi për kërkesën për informim mbi dosjen nuk ka kosto.



KORÇË

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kërkuar)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkuar)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
1070	KORÇE	GEMAL		KAMENICA		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1071	KORÇE	ZENEPE		CIPI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1072	KORÇE	HAKURAN		KAMI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1073	KORÇE	AIDA		QIRIJO		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1074	KORÇE	ESMA		PETRITI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1075	KORÇE	NEVRUZ		PETRITI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1076	KORÇE	YLLSON		PETRITI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1077	KORÇE	SUZANA		MORAVA		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1078	KORÇE					DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1079	KORÇE	DINO		VELO		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1080	KORÇE	KATERINA		BECI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1081	KORÇE	NURI		PASHO		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1083	KORÇE	IRFAN		KAMENICA		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kërkuar)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkuar)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
1084	KORÇE	RESMI		KAMENICA		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1085	KORÇE	ANA		KACORI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1089	KORÇE	RESHAT		KAMENICA		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1090	KORÇE	HAVA		KAPI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1086	KORÇE	DIELLI		OLLI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1087	KORÇE	GJEGJI		TEROVA		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1088	KORÇE	MIMOZA		ÇEZMOLLI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1091	KORÇE	ENGJELL		MOLLA		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1092	KORÇE	THEMISTOKLI		KOCA		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1094	KORÇE	AVNI		LIKA		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1095	KORÇE	YLLI		DUKATI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE

(vizon)

DOSJET E SIGURIMIT DIPLOMACIA

MEPJ i çoi e-mail, diplomati u alarmua. Pas 2 muajsh verifikimesh erdhi qartësimi

E quajtnë gabimisht njeri të Sigurimit, Llesh Kola padit Autoritetin e Dosjeve

E ngatërruan me një oficer me gjeneralitete të njëjta

Diplomati Llesh Kola është bërë protagoni i një incidenti të pakëndshëm pak javë më parë. Ai është etiketuar pa të drejtë nga institucionet shtetërore si i lidhur me Sigurimin famëkeq të diktaturës. Pas ballafaqimesh e verifikimesh të vazhdueshme, është kuptuar se bëhet fjalë për një tjetër person me të njëjtat gjeneralitete. Por, dëmi u bë. Diplomati Kola pohan se akuzat e padrejtë e ka përkeqësuar gjendjen e tij shëndetësore, duke e detyruar të qëndrojë 1 javë në spital.

HISTORIA

Gjithçka nisi më 16 maj 2018, kur në adresën e e-mailit të Llesh Kolës mbërriti një mesazh nga Ilirjan Zhupa, drejtor i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Europës dhe Punëve të Jashtme. Në këtë e-mail, Kola u informua se Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit ka zbuluar materiale në emër të tij. Ky Autoritet kish të dalë me një vendim më 24 prill, ku e nxirrte Kolën si njeri të Sigurimit dhe për këtë kishte informuar MEPJ.

I alarmuar, diplomati Kola ka kontaktuar kryetaren e Autoritetit të Hapjes së Dosjeve, Gentiana Sula dhe e ka informuar për pasaktësinë. Pas verifikimeve, Autoriteti ka dalë në muajin qershor me një vendim të ri: Diplomati Llesh Kola është "i pastër". Gjithçka ishte një keqkuptim: njeri i Sigurimit ishte një Llesh Kolë tjetër me gjeneralitete të përafërta me ish-ambasadadorin.

PADIA NE GJYKATE

Unë, i nënshkruari Llesh Zef Kola, prej datës 01.01.2018 në vazhdim me detyrë, drejtor ekzekutiv pranë Organizatës së Bashkëpunimit të Vendeve Anëtare të Detit të Zi (BSEC), me qëndrë në Stamboll, Republikën e Turqisë, paraqes sa më poshtë: Më datë 16.05.2018 jam informuar nga MEPJ për shkresën e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Nr. 325/2 prot., datë 26.04.2018, në



LLESH KOLA: VERIFIKIMET SIPERFAQESORE

Fakti që Autoriteti ka arritur në harkun 50-ditor të nxjerrë vendimin e ri për personin tim tregon se ata kanë pasur mundësi që ketë hetim të thëllur, ta realizonin gjatë procesit të kryer para marrjes së Vendimit nr. 74, datë 24.04.2018, detyrë kjo e cila nuk është kryer.

PERPUTHJA E ATESISE DHE VENDBANIMIT

"Në referencë të shkresës nr. 4499/1 prot., datë 25.05.2018, të DPGJC-me, rezulton se figuron edhe një person tjetër me gjeneralitete të përafërta me shtetasin Llesh Zef Kola, ku kemi përputhje të atësisë dhe vendbanimit", thuhet në vendimin e Autoritetit të Hapjes së Dosjeve të Sigurimit.

lidhje me Vendimin Nr. 74, datë 24.04.2018 në lidhje me personin tim.

Sipas vendimit të cituar më lart është vendosur:

1. Të informoj Institucionin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 18708 prot., datë 14.12.2017, "Listat emërore të personelit diplomatik, teknik, administrativ dhe të shërbimit, në MEPJ", se për zotin Llesh Zef Kola:

a. Nga verifikimet e kryera deri tani, figuron të ketë materiale, në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, në emër të tij, sipas nenit 29, pika 2, germa "b", të Ligjit Nr. 45/2015, "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e

ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", si dhe Kreut IX, pika 1 dhe 2, të Vendimit Nr. 846/2015, për miratimin e "Rregullores për shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë".

Pasi jam vënë në dijeni të këtij vendimi nëpërmjet postës elektronike, me datë 16.05.2018, nga z. Ilirjan Zhupa,

me detyrë, drejtor i Burimeve Njerëzore pranë MEPJ, i jam drejtuar menjëherë kryetares së Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, me kërkesë për të rishikuar vendimin Nr. 74, datë 24.04.2018 pasi gjatë gjithë jetës sime, aktivitetit studimor dhe profesional, nuk kam pasur asnjë lloj bash-

këpunimi me organe të tilla, qoftë lokale apo qendrore.

Pas disa kërkesave dhe shpjegimeve me shkrim drejtuar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, ky organ vetëm më datë 18.06.2018 ka dalë me Vendimin Nr. 174 nëpërmjet së cilit është vendosur:

"1. Të korrigojë Vendimin nr.74, datë 24.04.2018, me objekt "Kërkesa e paraqitur nga MEPJ, me shkresën nr.18708 prot., datë 14.12.2017 e përditësuar, lidhur me procesin e verifikimit të cilësive etike, morale dhe profesionale të shtetasit Llesh Kola", duke saktësuar dhe ndryshuar pikën 1, germa a), të këtij vendimi, si më poshtë:

a. Nga verifikimet e kryera deri tani, nuk figuron të ketë materiale, në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, për shtetasin Llesh Zef Kola, sipas Nenit 29, pika 2,



Llesh Zef Kola, drejtor Ekzekutiv pranë Organizatës së Bashkëpunimit të Vendeve Anëtare të Detit të Zi (BSEC)

kërkesës ankimore nr. 291/1 prot., datë 18.05.2018, të paraqitur nga shtetasi Llesh Kola, sipas objektit të kërkesës".

Arsyetimi i këtij komisioni si më poshtë, pranon praktikisht të gjitha shkel-



Kryetarja e Autoritetit të Hapjes së Dosjeve, Gentiana Sula

germa "b", të Ligjit Nr.45/2015, "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", si dhe Kreut IX, pika 1 dhe 2, të vendimit nr.816/2015, për miratimin e "Rregullores për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë".

2. Të informojë Institucionin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe vetë kërkuesin Llesh Zef Kola, mbi rezultatit të verifikimit, për shqyrtimin dhe trajtimin e thëlluar të

jet që ky komision ka kryer.

NGATERRESA ME USHTARAKUN NE LEZHE

Autoriteti, së pari me shkresën nr. 291/2 prot., datë 23.05.2018, "Mbi fillimin e shqyrtimit të trajtimit të kërkesës ankimore, të paraqitur nga z. Llesh Kola, për rishikimin e Vendimit nr. 74, datë 24.04.2018, i marrë nga Autoriteti", ka vënë në dijeni MEPJ-me, për shqyrtimin e Ankesës të paraqitur nga z. Llesh Kola me përparësi, sipas objektit të saj, në mënyrë që vendimi i marrë

Shitje me Ankad te Pare nga Studio Permbarimore L.D.C

-Apartamenti me nr. 2/260+2-6, vol 30, faqe 140, sip. 104.12 m2, ZK 8330, regjistruar ne Z.V.R.P.P. Tirane. Çmimi fillestar per shitje eshte 6.413.792 Leke.
Data e shpalljes 27.06.2018
Data e zhvillimit 20.07.2018 deri ne oren 16.00
Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Permbarimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.



nga Autoriteti të mos sjellë pasojat juridike për kërkuesin nga zbatimi i ligjit specifik të MEPJ-me.

1. Në referencë të shkresës nr. 86 prot., datë 18.05.2018 të MEPJ-me, rezultoi se, z. Llesh Zef Kola, në periudhën 26.06.1988 deri në datën 15.07.1991 ka qenë në shërbim diplomatik në Ambasadën e Shqipërisë në Algjer, Algjeri, që do të thotë se koha e tërheqjes në bashkëpunim me datë 5.04.1990, sipas Regjistrimit të Agjenturës Lezhë, Model 2, me nr. 3097, nuk korrespondon me detyrën funksionale që ka kryer në shërbimin diplomatik në Algjer, Algjeri. Në rastin konkret kemi të bëjmë me çështje problematike të juridiksionit dhe kompetencës, që burojnë nga vetë aktet mbi të cilat ka qenë rregulluar aktiviteti i ish-Sigurimit të Shtetit.

2. Në referencë të shkresës nr. 4499/1 prot., datë 25.05.2018, të DPGJC-me, rezultoi se figuron edhe një person tjetër me gjeneralitet të përafërta me shtetasin Llesh Zef Kola, ku kemi përfundim të atësisë dhe vendbanimit, më të dhënat e shënuara në fletën e Regjistrimit të sipërcituar, është në veri të qytetit të Lezhës, ndërsa fshati "Tresh" ku ka vendlindjen shtetasi i verifikuar nga ana jonë, sipas kërkesës së MEPJ-me është në jug të qytetit të Lezhës.

3. Gjithashtu, nga këqyrja e hartës së Shqipërisë për rrethin e Lezhës, vërehet se fshati "Mërq" i përcaktuar si vendlindje në fletën e regjistrimit të sipërcituar, është në veri të qytetit të Lezhës, ndërsa fshati "Tresh" ku ka vendlindjen shtetasi i verifikuar nga ana jonë, sipas kërkesës së MEPJ-me është në jug të qytetit të Lezhës.

4. Në referencë të shkresës nr. 5212/1 prot., datë 24.05.2018, të QPR-së në Ministrinë e Mbrojtjes rezultoi

PADIA/ Diplomati rrëfen pasojat e akuzës së gabuar: Përfundova në urgjencë

Kola: Akuza për spiun, ndenja një javë shtruar në spital nga zemra

"Ishte hapur thashethemi, miqtë m'u distancuan"

Mënjëherë pasi është njoftuar nga Ministria e Jashtme se ai rezultoi i lidhur me Sigurimin e Shtetit, Llesh Kola ka përfunduar në spital. Stresi që i ka shkaktuar ky informacion i gabuar i Autoritetit të Dosjeve ka lënë tek ai pasojat. Jo vetëm ka shkruar në urgjencë me shqetësime të zemrës, por ai ka vënë re se ditët në vazhdim edhe miqtë i janë larguar ose distancuar, pasi në Tiranë ka nisur të përflitej që ai ka qenë bashkëpunëtor i Sigurimit.

Për të gjitha këto, diplomati Kola ka bërë padi penale ndaj Autoritetit të Dosjeve. Por edhe sepse, sipas tij, ky organizëm nuk ka respektuar një tjetër normë ligjore: Ai duhet të informonte edhe vetë personin për informacionet që kishte, jo vetëm Ministrinë e Jashtme. Kola publikon edhe nenin e ligjit që sipas tij, ka shkëlqur Autoriteti i Dosjeve.

"1. Kur Autoriteti përcjell informacione në përputhje me parashikimet e nenit 28 të këtij ligji, të cilat përmbajnë të dhëna personale për personat të prekur, ai i njofton këta të fundit mbi llojin e informacioneve të përcjellura dhe marrësin e tyre.

2. Njoftimi, sipas pikës 1, të këtij neni nuk zbatohet kur Autoritetit i është komunikuar nga kërkuesi i informacionit se njoftimi i përcjelljes së dokumenteve, gjatë periudhës së verifikimit të dokumentacionit do të rrezikonte sigurinë publike apo do të pengonte zbatimin e ligjit".

Llesh Kola thotë se ai nuk është njoftuar nga Autoriteti i Dosjeve se paska rezultuar si bashkëpunëtor i Sigurimit.



SHTRIMI NE SPITAL

"Konkretisht vuaj nga një sëmundje zemre dhe situata e krijuar nga vendimi i mësipërm më ka detyruar të paraqitem me urgjencë në Spitalin Amerikan në Stamboll për trajtim mjekësor".

urimit.

"Ky parashikim ligjor nuk është respektuar nga anëtarët e Autoritetit, të cilët ka njoftuar MEPJ-me, duke më anashkalluar mua si person i prekur dhe njoftimi më ka ardhur nga MEPJ në formën e nisjes së procedimit, për dijeni, çka për mendimin tim ka qenë i qëllimshëm", thuhet në padinë që

diplomati Kola ka depozituar në gjykatë.

Ai shpjegon se nëse do të ishte njoftuar sipas parashikimeve të këtij neni, do ishte parandaluar dërgimi i informacioneve apo vendimeve të pasakta në institucionin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

"Kjo më ka sjellë dëm mor-

al, profesional, në karrierë dhe integritetin personal. Ky veprim më ka shkaktuar dëm të parikuperueshëm shëndetësor. Konkretisht, vuaj nga një sëmundje zemre dhe situata e krijuar nga vendimi i mësipërm më ka detyruar të paraqitem me urgjencë në Spitalin Amerikan në Stamboll për trajtim mjekësor, ku më rekomanduan të paraqitesha urgjentisht në klinikën kardiologjike të spitalit "Luigi Saço" në Milano, Itali, ku trajtohem prej dhjetë vitesh dhe kam qëndruar i shtruar për një periudhë 7-ditore, për të cilat bashkëlidhur paraqes aktet mjekësore që vërtetojnë pretendimin e mësipërm", rrëfen Kola në padinë e depozituar në gjykatë.

Ai shton se edhe miqtë nisën t'i largoheshin.

"Duke qenë prej më shumë se 30 vjet diplomat karriere, rrethi i personave që njoh dhe më njohin është relativisht i konsiderueshëm dhe për pasojë, shumë prej të cilëve kishin rënë në dijeni përpara meje për Vendimin 74 datë 24.04.2018, dhe kanë manifestuar ndaj meje forma të ndryshme distancimi. Ditë më vonë filluan edhe thashethemet ndaj meje si spiun i ish-regjimit të kaluar, çka kjo për mua ishte shumë e rëndë dhe reputacionin im u cenua. Duke marrë në konsideratë edhe situatën në të cilën jetojmë në shoqërinë tonë, ku përfolja shpejt është më e fortë se një vendim korrigjues", argumenton Llesh Kola në padinë e tij në gjykatë kundër Autoritetit të Hapjes së Dosjeve të Sigurimit të Shtetit.



se ekziston një person tjetër me të dhëna të përafërta me shtetasin Llesh Zef Kola, për të cilin QPR administrojnë dosjen personale, por njëherazi evidentohet fakti se për këtë shtetas në dosjen e tij personale nuk ka të dhëna që të ketë shërbyer si nënofficer aktiv në Repartin Usharak nr. 4340, për periudhën 1990-1991. Pra, evidentohet qartë që shtetasi Llesh Zef Kola që është objekt shqyrtimi dhe trajtimit të kërkesës së paraqitur nga ana e tij nuk është shtetasi me gjeneralitet e përcaktuar nga QPR-ja, për të cilin

ajo administrojnë dhe dosjen personale të tij.

Gjithashtu, në tërësinë e dokumentacionit të administruar nga ana jonë, shtetasi Llesh Zef Kola, figuron i kontrolluar nga Komisioni "Mezini" sipas ligjit nr.8043, datë 30.11.1995, "Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik", pavarësisht faktit se, vendimi i dhënë nga Komisioni "Mezini" më datë 12.06.1997 është fotokopje, por e gjithë praktika e korrespondencës së mbajtur midis institucioneve është

originale. Këtë fakt e sjell në vëmendje dhe vetë z. Kola, kur deklaroi se në kohën kur ka kandiduar për deputet në zgjedhjet e vitit 1997, për Kuvendin e Shqipërisë, Komisioni "Bezhani" ka ngatërruar të dhënat e tij (të diplomatit Llesh Zef Kola me shtetasin Llesh Zef Kola me profesion tjetër), ku është sqaruar gjithçka nga Komisioni "Bezhani", sipas pretendimeve të z. Kola.

Sa më sipër, në mbështetje të Nenit 5, pika 6, të ligjit 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të

Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", nga kërkimi i thelluar dhe nga verifikimi i dokumentacionit të sipërcituar i padiponueshëm në kohën e marrjes së Vendimit nr. 74 datë 24.04.2018, është legjitime korrigjimi i pasaktësisë së informacionit dhe ndryshimi i vendimit nr. 74, datë 24.04.2018, të marrë nga Autoriteti, për shtetasin Llesh Zef Kola. Në këtë vendim duhet të saktësohet se, për shtetasin Llesh Zef Kola nuk figuron të ketë materiale në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit.



Mbrojtësi ka luajtur 10 finale, i ka fituar të dhjeta

Talismani Varane, Deshamp shpreson tek ai

Shumë pak vetë e dinë, por Didier Deshamp ka në dispozicion për finalen e madhe një fatsjellës, një lojtar që nuk ka humbur kurrë në karrierën e tij asnjë finale. Nuk është as Mbape e as Griezman, asnjë nga yjet e "gjelave", por një qendërmbrojtës si Rafael Varane. Në dhjetë finale

ku Varane ka qenë prezent, i ka fituar të dhjeta. Vetëm 25 vjeç, Varane është një nga qendërmbrojtësit më të fortë në botë, një digë e vërtetë jo vetëm për Real Madrid, por edhe përfaqësuesen franceze. Varane ka konfirmuar se është një futbollist që nuk trembet nga ndeshjet e mëdha, përkun-

drazi, janë pikërisht këto sfida që e motivojnë edhe më shumë. Tradita e Varane me trofetë dhe finallet fillon në vitin 2014, ku Real Madrid mposhti Barcelonën në finalen e Kupës së Mbretit, që nga ajo ditë Varane vetëm ka festuar pas një finaleje, duke vijuar më pas me 4 Champi-

on League, edhe shumë trofë të tjerë. Në të vetëm finale ku Varane nuk ka marrë pjesë ka qenë ajo e Europianit dy vite më parë, një dëmtim i hoqi mundësinë për të luajtur kundër Portugalisë, përfundimi dihet, pasi kupën e ngriti Ronaldo. Në Moskë nuk ka asnjë shans që Varane të mungojë, Didier Deshamp beson shumë tek fatsjellësi Varane, por mbi të gjitha beson tek aftësitë e tij.

Dy ekipet më të mira të "Rusi 2018" do të ndajnë në "Luzhniki" trofeun më të rëndësishëm

Franca përballë Kroacisë, Kupa e Botës është në mes

Sot në orën 17:00, në Moskë luhet finalja e madhe

Jeton Selimi

Pavdekshmëria sportive pat mbërritur 20 vjet më parë, kur çoi në qiellin e Parisit Kupën e Botës, por brezi i artë francez nuk kënaqet kurrë. Zidanit nuk i mjaftoi që të ishte mes më të mëdhenjve të planetit, por theu çdo rekord si trajner me tre Champions radhazi. Deshamp që në vitin 1998 mbronte shpatullat e "Zizus", tani kërkon të ulët në tavolinë me Zagallos dhe Bekenbauerin. Jemi në finale dhe shumë pyetje erdhën për atë finale të humbur dy vjet më parë, ndërsa Deshamp nuk i lejon vetes shpërqendrim. "Grupi është ndryshe nga ai i dy viteve më parë. 14 lojtarë janë të rinj dhe e kanë zbuluar këtu në Rusi se çfarë do të thotë një turne i madh. Por nëntë prej tyre e dinë mirë sesi shkojnë dhe sesi mbaroi Europiani dhe kjo do të na ndihmojë. Atëherë nuk bëjmë gabime dhe nëse do të kishim fituar, sot do të flisnim ndryshe. Gjithsesi, në një finale fjalët kyçe janë tri: qetësi, besim dhe përqendrim. Të jesh në finale është një kënaqësi e madhe". Më pas Deshamp analizon ekipet. Kroacinë dhe Francën, duke vlerësuar maksimalisht elementet më me vlerë të të dyja ekipet. "Modriç është lojtar i lëvizshëm, ka inteligjencë taktike. Mesi dhe Hazard kanë më shumë veprimtari individuale dhe janë sulmues. Ai është mesfushor dhe lojtar për ekipin. Në veprimtari të mëdha ka më shumë vlerë forca kolektive sesa talenti individual. Mbape? Ai është një talent i madh dhe e ka treguar këtë gjatë turneut. Nuk e trajtoj ndryshe nga të tjerët, por jam gjithmonë më shumë i kujdesshëm me të rinjtë". Franca vjen me artilerinë e rëndë në këtë ndeshje. Grupi gëzon formë të shkëlqyer dhe në këmbët e tyre kanë më pak minuta sesa Kroacia, që ka luajtur tri ndeshje radhazi me kohën shtesë. Deshamp pritet të rreshtojë formacionin tip, me të cilin ka përbulluar fushatën ruse. Kroacia ka shenjëstuar 13-të, pasi është skuadra e 13-të që debuton në një

finale Botërore. Dy të fundit, Franca në vitin 1998 dhe Spanja në vitin 2010 ngritën Kupën. Por duke qenë se Kroacisë as nuk i interesojnë skaramancitë, ka adoptuar mënyrën e zgjedhur nga një tjetër ekip i madh, që nuk arriti trofeun, Holanda e vitit 1974. "Futuri në fushë dhe argëtohuni", thoshte Johan Kruijff. Në këtë linjë është edhe trajneri i Kroacisë, Zlatko Dalic. "Le të argëtohem, ta shijojmë dhe të luajmë duke shfrytëzuar momentin. Nëse fitojmë, askush nuk do të jetë më krenar se ne. Nëse humbasim, do ta bëjmë me dinjitet dhe do të përgëzojmë Francën. Në stërvitje nuk këmbëngul shumë, nuk



kam asgjë se çfarë t'u stërvit. E di se nëse ndonjë lojtar nuk do të jetë në 100% të tij, do të ma thotë. Lojtarët e mi e dinë se tek unë kanë gje-

tur një mik. Unë i respektoj ata dhe ata më respektojnë mua. Vendimet i marr gjithnjë pasi konsultohem me ata".

Natyrisht që lojtarët e ndihmojnë. Në skuadër ai ka lojtarë që nuk sillen si yje, por që janë burra që mbajnë bashkë ekipin. Në krye të të

gjithëve, Maxuqiç. "Mario është një toplojtar. Për atë nuk ka asnjë ndryshim nëse luan një miqësore apo një finale, nëse luan si qendër sulmues apo në krah. Asnjë trajner nuk do të ketë kurrë problem me të, sepse për çdo skuadër do të ishte i rëndësishëm". Kroacia vjen më e lodhur se Franca në këtë finale. Skuadra ballkanase ka luajtur tri ndeshje radhazi me kohën shtesë si dhe gjendja e Perisic ka shqetësuar disi ambientin. Gjithsesi, Dalic duket se do të ketë shërbimet e Simo Vrsaljkos, që ka rikuperuar dëmtimin e pësuar në gjysmëfinale ndaj Anglisë.

Mënie dhe Hazard, autorët e golave

Belgjika thyen Anglinë në finalen e vogël

dhe me një "tap in" të saktë thyen Pikfordin duke çelur rezultatin. Goli nuk i kënaqte belgët, që fluturojnë në fushë si zana magjike duke çorituruar mbrojtjen ishullore. Anglia do të shfaqet në minutën e 14-të me Delf që gjuan nga jashtë zonës, por pa forcën e duhur. Më pas Kompani mbyll shkëlqyeshëm në zbritjen e rrezikshme të Loftus Çek, ndërsa nga këndorja Meguajër nuk gjen portën. Herri Kejn në të 24-ën do të ketë një rast të mirë shënimi, por gjuan keq pas pasimit të Stürling. Belgjika rishfaqet në zonën angleze në minutën e 35-të me një kthesë të befasishme të Al-

derveireld, por që del pak mbi tra, ndërsa në fund të pjesës së parë, De Bryjn shërbehet bukur nga Hazard, por mbyllet nga Meguajër. Belgjika shkon në pushimin e ndeshjes me avantazhin minimal. Pjesa e dytë nis me një mundësi të mirë për Anglisë, por Vertongen është i vëmendshëm ndaj Stouns. Në minutën e 56-të De Bryjn çan si me magji mbrojtjen angleze me një pasim prej fenomenit, por Lukaku gabon kontrollin e topit dhe i jep mundësinë Pikfordit të bllokoi aksionin. Anglia i shkon fare pranë golit me atë të Dajër, por mes tij dhe rrjetës shfaqet mrekullisht Alderveireld, që e largon



topin para se të kalojë vijën fatale. Janë minuta të mira për Anglinë, që kërcënon sërish me Meguajër, i cili edhe njëherë shfaqet rrezikshëm me kokë, por topi del për pak jashtë. Pas këtij momenti Anglia fiket dhe Belgjika mund të bëjë çfarë të dojë. "Djajtë" dalin me tri pasime të zona e Pikfordit dhe herë nxitimi dhe herë gardiani i Evertonit bëhen bllokadë, sidomos në minutën e 80-të, kur Pikford ndal me një pritje të klasit të lartë guajtjen e

bukur të Mënie. Gjithsesi, Belgjika do të shënojë dhe do ta bëjë dy minuta më vonë, kur sërish në kundërsulm të shpejtë De Bryjn shërben në zonë për Hazard, me elfin trupvogël që thyen Pikforin e pafaj. 2-0 dhe fatet e takimit vulozen këtu. Belgjika feston një vend të tretë historik, Anglia shkon në shtëpi pa medalje, por e vetëdijshme se me eksperiencën e duhur, në Katar mund të jetë një pretendente serioze.



NGA AVNI ALCANI

Libri "Psalltiko" është një nga reliket më të rralla dhe më të çmuara në historinë e shkrimeve shqip. Libri në dorëshkrim është gjetur në fshatin Polis të Librazhdit. Ai përmban disa fragmente ungjijsh nga Mateu dhe Gjoni, të cilat janë përkthime nga bibla. Libri është me format të vogël, rreth 10 x 7 cm dhe ka 30 fletë. Titulli origjinal i librit është "Psalltiko",¹⁾ por ai njihet edhe si "Dorëshkrimi i Ungjijve",²⁾ kurse në literaturën shkencore njihet si "Anonimi i Elbasanit".³⁾ Dorëshkrimi mendohet se është hartuar rreth vitit 1761 të shek. të 17-të.

Duke qenë se ky libër është i shkruar me një alfabet të veçantë, që ende nuk njihet autori i shpikjes së tij, si dhe për shkak se është gjetur në fshatin Polis të Librazhdit, dorëshkrimin kemi preferuar që ta quajmë "Dorëshkrimi i Polisit", apo dhe "Alfabeti i Polisit".⁴⁾

1. Libri "Psalltiko", si objekt studimi

"Psalltiko" është një

nga librat më të hershëm të gjuhës shqipe i shkruar me një alfabet origjinal. Alfabeti i përdorur në tekst është i përbërë nga 40 gërma dhe ka 6 113 fjalë të shkruara. Shkronjat janë një ndërthurje e disa germave të alfabetit grek (7 germa), të alfabetit sllav (2 germa) dhe pjesa më e madhe prej tyre (rreth 31 germa) janë krijime të

reja origjinale. Sipas studiuesve, alfabeti i përdorur në dorëshkrim i përshtatet më së miri gjuhës shqipe. "Mund të thuhet bile, - shkruan Robert Elisie, - se ai i përshtatet më mirë se alfabeti shqip i sotëm".⁵⁾ Libri "Psalltiko" ka qenë objekt hulumtimi i disa prej studiuesve më në zë të fushës së studimeve albanologjike, si nga Prof. Dhimitër S. Shuteriqi, Prof. Mahir

Domi, Prof. Injac Zamputi, Dr. Robert Elisie etj.⁶⁾ Pas tekstit të shkurtër të Ungjillit të Pashkëve të shekullit të 15-të, Dorëshkrimi i Ungjijve është vepra më e vjetër e letërsisë orthodoxe shqiptare dhe, në të njëjtën kohë, përkthimi i parë orthodox i Biblës.⁷⁾

Studiuesit që janë marrë me historikun dhe prejardhjen e librit,

kanë shprehur mendime të ndryshme në lidhje me autorin e hartimit të librit. Sipas Prof. Dh. S. Shuteriqi libri është shkruar nga Teodor Bogomili,⁸⁾ ndërsa Dr. R. Elisie, në një studim kushtuar këtij libri, ka shkruar se ai është hartuar nga Gregori i Durrësit.⁹⁾ Libri ka qenë në përdorim edhe të një murgu me emrin Papa Totasi, i cili, ashtu si Teodor Bogomili, kanë shkruar emrat e tyre në kapakun e librit.

Dorëshkrimi i Polisit mendohet se është pasardhës i një tradite të hershme të shkrimit të shqipes para pushtimit turk, që mund të ketë qenë i përdorur në Arbërinë e asaj kohe, por për fat të keq nuk është gjetur asnjë kopje tjetër e ngjashme me të.

→ Vizion në faqen 14

“PSALLTIKO”

Përkthimi i parë shqip orthodox i Biblës

{ Në këtë numër: DASHA DRNDIÇ PËRMES IMAZHIT TË MAKS VELOS, AVNI ALCANI, GJERAK KARAIKAJ, ILIR KALEMAJ, NDREK GJINI ETJ... }

A

ARGUMENT

Libri "Psalltiko" është një nga reliket më të rralla dhe më të çmuara në historinë e shkrimeve shqip. Libri në dorëshkrim është gjetur në fshatin Polis të Librazhdit. Ai përmban disa fragmente ungjijsh nga Mateu dhe Gjoni, të cilat janë përkthime nga bibla. Libri është me format të vogël, rreth 10 x 7 cm dhe ka 30 fletë. Titulli origjinal i librit është "Psalltiko",¹⁾ por ai njihet edhe si "Dorëshkrimi i Ungjijve",²⁾ kurse në literaturën shkencore njihet si "Anonimi i Elbasanit".³⁾ Dorëshkrimi mendohet se është hartuar rreth vitit 1761 të shek. të 17-të.

"Dorëshkrimi i Polisit" dhe "Sistemi i numërimit me rabush"

NGA AVNI ALCANI

Vijon nga faqja 13

Dorëshkrimi i Polisit mendohet se është pasardhës i një tradite të hershme të shkrimit të shqipes para pushtimit turk, që mund të ketë qenë i përdorur në Arbërinë e asaj kohe, por për fat të keq nuk është gjetur asnjë kopje tjetër e ngjashme me të.

1. Historiku i zbulimit të dorëshkrimit të Polisit

Vijon nga

Por cili është historiku i zbulimit të dorëshkrimit?

Sipas dëshmisë që na jep Prof. Dr. Dh. Shuteriqi, një nga publikuesit e parë të këtij dorëshkrimi, ka qenë Losh Papamihali nga qyteti i Elbasanit, shok i Kostandin Kristoforidhit dhe një veprimtar i njohur i mësimt të shqipësisë, i cili ishte i pari që e ka pasur në pronësi librin "Psalltiko". Loshi e kishte blerë librin në shekullin e 19-të nga një fshatar prej Polisi, i cili quhej Haxhi Tarushi. Ai kishte blerë nga Tarushi edhe disa libra të tjerë të vjetër, por ky libër kishte qenë më i veçantë, pasi atë nuk kishte mundur ta lexonte askush prej zotëruesve të tij.

Polisari i pati dëshmuar Loshit se këto libra ishin "të kohës kur Polisi nuk ishte kthyer ende mysliman".¹⁰⁾ Polisi mendohet se është kthyer në fenë myslimane në krye të shek. XIX. Kur vdiq Losh Papamihali, librat dhe dokumentet e vjetra që ai zotëronte, ia besoi nipit të tij, gjykatësit Spiro Xhufka. Papamihali i kishte lënë porosi nipit që këto libra të publikoheshin "kur të bëhet Shqipëria".¹¹⁾ Dorëshkrimi i Polisit bashkë me librat e tjerë përfunduan në duart e Lef Nosit, për të cilin Prof. Shuteriqi shkruan se "Spiros, një pjesë të tyre, bashkë me dorëshkrimin e përmendur, ia përvetësoi L. Nosi, në arkivin e cilit u gjetën".¹²⁾ Pas vdekjes së Spiro Xhufkës, libri u tashëguar nga djali i tij, Ilia Xhufka. Prof. Dr. Dh. Shuteriqi dëshmon se as Losh Papamihali, as Spiro Xhufka, as Ilia Xhufka dhe as pasardhësit e tjerë të tyre, nuk kishin arritur ta lexonin dorëshkrimin.¹³⁾ Pas Luftës së Dytë Botërore, me dënimin kapital që regjimi komunist i dha patriotit Lef Nosi, Dorëshkrimi i Polisit, së bashku me një pjesë të librave dhe dorëshkrimeve të tjera që kishte pasur në zotërim intelektual i njohur elbasanas, hynë në Arkivin e ish-Institutit të Shkencave.

Do të ishte viti 1949 kur libri "Psalltiko" pa për herë të parë




dritën e botimit. Dorëshkrimi u botua nga Prof. Dr. Dhimitër S. Shuteriqi në Buletinin e Institutit të Shkencave, me titullin: "Anonimi i Elbasanit. Shkrimi shqip në Elbasan në shekujt XVIII-XIX dhe Dhaskal Todhri".

2. Shkrimi i numrave matematikorë. Sistemi i numërimit me rabush në Polis

Krahas "Dorëshkrimit të Ungjijve" në Polis janë zbuluar edhe mbishkrime të tjera, siç është ai i shkrimit të numrave matematikorë, i quajtur "Sistemi i numërimit me rabush". Ky sistem ka qenë i shkruar me disa simbole origjinale dhe të veçantë, të cilat u korrespondonin numrave aritmetikë. Shkrimi i numrave matematikorë mendohet të ketë qenë një traditë e hershme shkrimi para pushtimit turk.

Sistemi i numërimit me



rabush ka qenë i përdorur kryesisht nga barinjët polisarë. Polisarë i "shkruanin" numrat duke i gdhendur mbi një shkop prej druri, që quhej rabush.¹⁴⁾ Po përse numrat ishin shkruar në dru dhe jo në pergamenë, siç ishin

Sistemi i numërimit me rabush

Sistemi i numërimit me rabush ka qenë i përdorur kryesisht nga barinjët polisarë. Polisarët i "shkruanin" numrat duke i gdhendur mbi një shkop prej druri, që quhej rabush.¹⁴⁾ Po përse numrat ishin shkruar në dru dhe jo në pergamenë, siç ishin shkruar gërmat e alfabetit në librin "Psalltiko"? Ndoshta në një traditë më të hershme edhe ai ka qenë i shkruar në pergamenë, por, me kalimin e kohës dhe me humbjen e traditës së shkrimit, barinjët polisarë, të cilët qenë në pjesën më të madhe të tyre analfabetë, vijuan ta ruanin traditën e shkrimit të numrave duke e shkruar atë në shkopinj druri. Kjo "teknikë e re" bëri që të humbasë tradita e shkrimit me letër (ose pergamenë) që të shkruhej siç kishte qenë më parë.

shkruar gërmat e alfabetit në librin "Psalltiko"? Ndofta në një traditë më të hershme edhe ai ka qenë i shkruar në pergamenë, por, me kalimin e kohës dhe me humbjen e traditës së shkrimit, barinjët polisarë, të cilët qenë në pjesën më të madhe të tyre analfabetë, vijuan ta ruanin traditën e shkrimit të numrave duke e shkruar atë në shkopinj druri. Kjo "teknikë e re" bëri që të humbasë tradita e shkrimit me letër (ose pergamenë) që të shkruhej siç kishte qenë më parë.

Rabushët përgatiteshin prej dru thane, pasi thana ka shkopinj të drejtë, të fortë dhe pa palcë. Gjatësia e shkopinj arrinte nga 1,5 m deri në 2 m. Shkopi i thanës qerohej nga lëkura dhe gdhendej

Veç "Dorëshkrimi të Ungjijve"

Krahas "Dorëshkrimit të Ungjijve" në Polis janë zbuluar edhe mbishkrime të tjera, siç është ai i shkrimit të numrave matematikorë, i quajtur "Sistemi i numërimit me rabush". Ky sistem ka qenë i shkruar me disa simbole origjinale dhe të veçantë, të cilat u korrespondonin numrave aritmetikë. Shkrimi i numrave matematikorë mendohet të ketë qenë një traditë e hershme shkrimi para pushtimit turk.

duke krijuar katër faqe dhe katër kulme (këndë). Numrat shkruheshin në faqen kryesore të rabushit dhe në njërën nga kulmet e tij. Shkrimi i numrave bëhej me anë të një thike të vogël xhepi. Simbolet, apo numrat që shënoheshin në rabush, ishin: numrat 1 (një), 5 (pesë), 10 (dhjetë), 50 (pesëdhjetë), 100 (njëqind), 500 (pesëqind) dhe 1000 (njëmijë). Simbolet e gdhendeshin duke i radhitur numrat njëri pas tjetrit, nga e majta në të djathtë. Me anë të këtyre simboleve-numra zhvilloheshin veprimet matematikore, siç ishte formimi i shifrave. Formoheshin numra me një shifer, dy shifra, tre shifra, katër shifra dhe më shumë shifra. Kryeheshin disa veprime matematikore, siç ishin mbledhja e numrave, zbritja dhe shumëzimi. Veprimi i zbritjeve bëhej duke i fshirë (zhdukur) numrat nga rabushi, kurse veprimi i pjesëtim-it nuk njihje.

Rabushët përdorreshin kryesisht nga barinjët për të shënuar: 1. sasinë e bulmetit, si qumështin, djathin, gjalpin, gjizën, mishin, leshin, lëkurët etj. dhe 2. sasinë e parave që siguronin nga shitja e prodhimeve të tyre.

Përdorimi i rabushëve në Polis ka vijuar deri në mesin e shek. të 20-të. Më vonë sistemi i numërimit me rabush vijoi të përdorej për forcë zakoni nga ndonjë bari i vjetër. Sot rabushët janë nxjerrë jashtë përdorimit.

Në vitet 1979, 1983 dhe 1985 autori i këtij shkrimi ka qenë pjesë e tri ekspeditave informative në kërkim të traditave blegtorale në zonën e Polisit. Gjatë këtyre ekspeditave u kontaktua me disa barinj të vjetër polisarë, të cilët kishin qenë njohës dhe zotërues të shkrimit të numrave në rabush. Një i tillë ishte Qemal Muzhaqi nga Polis-Vilani, i cili në vitin 1979

1	Σαββηκός Σαμφορ	salbbhikos psallmosa
2	θεόλοπος	Theólorosé
3	βοκομιχάος	Bogomilosaé
4	θωροπος	Thodorosé
5	εραυροπος	e eravrotosé
6	γλοφασο	glosasou
7	καλαμοσ	kallamosé
8	οξισγραφίς	oksigrafis
9	ταπα τα το τα ο	tapata totasi
10	ορέοσέ κελί	oreose keli

T

TREGIMI

NGA GJERAK KARAIKAJ*

Një ngrehinë gërmadhe madhe po ndërtohej në qendër të qytetit. Nën një shi të hollë, thuajse të padukshëm, por të pandërprerë që kullonte nga qielli gri, kolona të përhimta njerëzish, përcillnin dorë më dorë blloqe të gdhendura gurësh, që ishin përgatitur diku tjetër. Duke sikur natyra po vajtonte për dikë dhe s'pranonte të ngushëllohej. Kolonat e gjata gurë mbajtëse, merrnin pjesë edhe ato në atë pikëllim. Zelli i punës dukej sikur mbytej e mposhtej nga ngjyra gri e errët e zbardhëlluar e veshjeve uniforme, nga fytyrat e rreshkura e të zbehta dhe nga sytë e zgurdulluar të zinj si thëngjilli që shkëlqenin në atë zymti më tepër se duhej. Një palë tjetër burrash, të mbledhur turra-turra, që kapnin një shtrirje në hapësirë sa të hante syri, përgatisnin llaçin me lopatat e tyre bishtëshkurtëra. Të mbathur me çizme llastiku të zeza të bëra gri nga llaçi, mbledheshin kokë më kokë sa po përgatitje bërë gati, ngulnin e shkulinin prej tij çizmet e tyre. Nga kjo llokoçitje ritmike krijohesh një zhurmë e zhapullimë shurdhuese që i ngjante uturimës së një deti të egërsuar dhe dëgjohej deri në shpatet e maleve që mbyllnin horizontin. Varganë kovash llamarine të ndryshkura, të mbajtura nga duar të nxira me kallo e deje të kërcyera, derdhnin ujë mbi kapaçitë e llaçit, pastaj merrnin një lakore për t'u kthyer bosh paralel me vargun që vinte.

Kur binte mbrëmja ata punonin dhe një copë herë të mirë nën dritën e pafundme të fenerëve që dukeshin si gjarpërinj të zjarrtë; pastaj largoheshin për në kapanonet e tyre të stërgjatur e të rreshtuar po aq mirë, sa dhe ata vetë në orët e punës. Shtriheshin mbi dyshkët e mbushur me kash-të dhe mbuloheshin me batanije prej lesi dhie, të ngrëna nga koha dhe mushamatë e tyre të lagura. Në mëngjes herët, akoma pa zbardhur dita, dëgjohej çanga e zgjimit, hahej çorba dhe kolonat zinin vendet e tyre të punës, të rreshtuar njëjloj si një ditë më parë. Kur bënte ndonjë copë kohë me diell, mushamatë nxirrnin një avull të dendur që bashkë me erën e keqe të mykut mbulononte gjithçka, sa që kureshtarët që donin të shihnin e të merrnin vesh ç'bëhej atje, shquanin më pak nga ajo vepër se në ditët me shi. Pastaj hapësira përreth thahej aq shpejt sa balta kthehej në pluhur. Pa prituri qielli vishej përsëri me një tyl të hollë të hirtë sikur të ishte krijuar nga ai avull i ngrohtë që lëshohej nga deti pafund i mushamave të përhimta. Vetëm horizonti mbetej i zbardhët, i mbyllur tinzisht nga një dritë e mekur pa shkëlqim, që e bënte më të trishtë kontrastin. Rralleherë, kur bënte kohë e thatë, frynte një erë e fortë që ngrinte shtëllunga pluhuri mbushur me

Autori mundohet të ngrejë një alegori për kohën e komunizmit, një temë që e ngacmon vahdimisht. Në vitet e fundit, studiuesi i njohur i monumenteve, i është kushtuar letërsisë, anipse mund të ishte pak më i kursyer në rrëfimin e tij sa i përket gjatësisë dhe të ishte më i kujdesshëm për formën. Sa i përket narracionit, autori tregon se mund t'i përshtatet, por teknikat ende i duhen të përsosën më tej...

PIRAMIDA ose LEGJENDA E MURIMIT

copa letrare e gjetesh të kalbura të fshira nga rrugët dhe koshat e plehrave, deri edhe degë të shqyera pemësh ngriheshin në atë vorbull. Ajo pamje e kobshme të krijonte përshtypjen sikur ajo vepër nuk po bëhej për mirë, në mos po nuk do të përfundonte kurrë.

Kur vinte koha e ngrënies së drekës, rreshtat e punëtorëve nuk prisheshin, ata vetëm se bëheshin më të ulët, pasi ç'do krijesë në veçanti ulej atje ku e zinte ora. Hapeshin njëherësh gazetetat që mbështillnin hajën e thatë të zgjedhur sipas dëshirës së secilit, por që nuk ndryshonte aspak në përmbajtje. Njerëzit, të cilëve nuk u ishte dhënë mundësia për të marrë pjesë në atë aksion përmasëmadh, për mungesë sheshesh pune, hapnin dritaret dykanatësh, drejtonin veshët nga vinte zaurima e gazetave dhe përshtëritnin midis tyre apo me vete: "Tani ata po hanë". Në këtë thënie ndjehej një farë qefmbetjeje e zbehtë apo xhelozie e ndrojtur që secili e mbante të fshehur thellë, në skutat me sekrete brenda vetes.

Ajo që po ndodhte ishte e pa shpjegueshme, pas vitësh të tëra pune ndërtesa nuk po lartoheshin aspak. Kishte vdekur Gogu i Madh, i Pazëvendësueshmi, më i madhi i të gjitha kohërave dhe vendeve dhe mezi priste që t'i bëhej varri e të prehej i qetë aty. Flitej se do të ngruhej një piramidë apo diçka e ngjashme me të. Më e madhërishme nga paraardhëset që do të kishte dhe shumë hapësira dritëplote brenda saj, që i ndjeri të mund të nderohej edhe nga brenda.

Turma punëdashëse kryente të njejtat rite e veprime. Po ata rreshtat të gjatë gurë mbajtës. Po ato kova që lëviznin pa pushim e derdhnin ujë. Po ato çizme që llokoçisnin llaçin. Po ajo çorbë e mëngjesit dhe po ajo zhurmë zilindjellëse gazetash gjatë hajes së drekës. Por

kur ktheheshin në punë, mëngjezeve në të gdhirë, gurët e vendosur në mur një ditë më parë, i gjenin të rëzuar përtokë. Por kjo nuk e dekuraonte turmën. Për ata e rëndësishme ishte ajo që bënin dhe jo ajo që bëhej. Veprimi dhe jo rezultati. Se ata ishin njerëz të lirë dhe liria e tyre qendronte pikërisht në faktin që nuk kishin përgjegjësi për atë që bëhej. Lirinë e dhuruar e shpërblenin me të gjitha mënyrat që u kërkohesh përtej punës së përditshme. Sa më i padukshëm të qe rezultati, aq më tepër u shtohesh vullti për punë dhe më gjatë qëndronin të ndezur gjarpërinjtë e zjarrtë të fenerëve në orët e vona të natës. Por ndryshe mendonin ata atje lart; çështja ishte sa e ngutshme aq edhe e një rëndësie të jashtëzakonshme, se bëhej fjalë për një të vdekur jo të zakonshëm. Në rastet e tilla të jashtëzakonshme, mosrrealizimit të një detyre do t'i përgjigjej domosdoshmërisht dhe gjendjes së jashtëzakonshme. Për të mirën e përgjithshme, liritë e fituara si dhuratë, kufizohen përkohësisht. Gjendja e jashtëzakonshme nuk u shpall me bujë e tambura, por nën zë me pëshpërimë, gati në heshtje, vetëm me përhapjen e një parulle kuptimqartë. Parrulla është si kënga që të ngre peshë. Koncentrat i një letërsie të tërë, kultivuar në dekada. Përvojë e ngjeshur jete. Jo, gjithkush mund të formulojë parulla. Gogu i Madh i Pazëvendësueshmi, i kishte lënë ato, amanet me shkrim, për brezat që do të vinin. Ai kishte shumë kërkesa ndaj vetes. Krijoi parrulla, jo për të duruar lodhjen, mundimin, goftë dhe hallet e përditshme, si kishin bërë paraardhësit dhe bashkëkohësit e tij në vende të tjera, por për t'i zhdukur ato rrenjësisht, për t'i bërë të papranishme, deri në atë shkallë sa dhe koncepte të tilla të mos përdroreshin, veçse për qënie shumë të largëta, të panjohura dhe që nuk i ngjanin fare atyre, të popullit që ai udhëhiqte. Kjo punë kërkonte



kohë, e mbi të gjitha mprehtësi. Duheshin hulumtuar vëllime të pafundme letrare e politike, të frymëzuara nga ai vetë. Parrulla që pritej do të ndryshonte disi nga të parat, se ishte për një rast të veçantë e të paparashikueshëm; dhe për më tepër do të formësohej nga pasardhësit. Më në fund parulla u shfaq e plotë dhe e qartë si drita e diellit: "Dhimbjen t'a kthejmë në forcë," që do të thoshte në stërmundim. Me fjalë më të thjeshta ua shpjeguan fillimisht çizmeve, pasi mushamatë dhe kovat, thithnin më shumë, më pas të tjerëve; dhe parulla u njësua me shprehjen: "Përjetë vdekjen, që pavdekësi të mbijetojë." Ata u përgjigjën: "Japim nga ditët tona," dhe ashtu u bë, disave u morrën të gjitha ditët dhe u ndanë të tjerëve për frymë, si ndahen tokat në vendet demokratike. Një njeri i vetëm nuk është në gjendje të formësojë një parrullë; dhe as t'a kuptojë atë; por ata e kuptuan, se e kuptuan shumë veta njëherësh. Pra ata tani nuk do të mjaftoheshin vetëm me pjesën e parë të frazës, që e njihnin dhe e zbatonin me dëshirë e entuziazëm, por merrnin përgjegjësi dhe për të dytën, pra për atë që bëhej. Ky ishte një çënim i lirisë së gënies, por ishte i përkohshëm, i pazakontë, për

shkak të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme. Gjithsesi ata, më shumë i mbante gjallë, ajo monotoni joshëse dhe besimi në përjetësinë e saj, se sa rezultati i prishëm; dhe kësajsoj ndjeheshin të lirë brenda vetes.

Për të lidhur shkaku me pasojën, u dëshën mendje më të kthjellta e më praktike. U dyndën një mori kasketash, që mbulonin koka goxha të ngjashme, për të parë në vend burimin e së keqes. Sëpari u dha urdhër të shtojë në llaç përberësi cimento, ndërsa disa llaçbërës u dënuan me varje si sabotatorë. Një proces i ngjashëm nisi, edhe në fabrikën e cimentos. Më pas dikujt i shkrepri një mendim, se shkaku i dëmtimit mund të kishte qenë përdorimi i ujërave të kripuar gjatë gatimit të llaçit. Të nesërmen në varganin e kovave munguan shtatëmbëdhjetë syresh. Ato u varën bashkë me mbajtësit. Mbetej të shqyrtohej, një çështje tepër delikate, dhe mjaft më e maskuar nga njëherësh. Pra ata tani nuk do të mjaftoheshin vetëm me pjesën e parë të frazës, që e njihnin dhe e zbatonin me dëshirë e entuziazëm, por merrnin përgjegjësi dhe për të dytën, pra për atë që bëhej. Ky ishte një çënim i lirisë së gënies, por ishte i përkohshëm, i pazakontë, për



A

ARGUMENT

Numri 47-të i "Poetekës" është promovuar sërish në rrjetin Eurozine, këtë herë për frymën dhe përcjelljen e këndshme të letërsisë dhe argumenteve të saj...

POETEKË

- (Shqipëri) Nr. 47 (2018)



Poeteka fokusohet në 'literaturën e angazhuar'. Artikulli kryesor që i përket Silvana Lekës argumenton se ku qëndron angazhimi politik në shekullin e njëzet e një, "përbalë subjektit të emigrantëve, rikthimit të histerisë masive dhe pranisë së kampeve në Evropë". Cili është ndikimi i luftërave në Siri dhe valës në rritje të fashizmit politik dhe kapitalizmit agresiv në vendet e Evropës Juglindore?

Autorja në trajtesën e vet i kthehet historisë së elaboruar mirë të angazhimit letrar nga Realizmi Socialist i imponuar nga komunizmi shqiptar dhe angazhimi i

Sarrit në erozionin e hapur të përkushtimit prej retorikës të post-modernizmit. Ajo konstaton se natyra e angazhimit është duke u riformuar, ndërkohë që etja e lexuesve është më e madhe për informacionin sesa letërsinë në vetvete.

Eurozine ka zgjedhur për Poeteka-n shkrimin "përkushtuar ndaj idealeve që u kanë mbijetuar shekujve, veçanërisht atë të lirisë", duke përfshirë përkthime të poetit radikal çeçen Jazra Khaleed, i cili shkruan në greqisht, dhe shkrimtarë serbë që reflektojnë mbi problemet e trazuara, por jo gjithmonë me fokusin në konfliktin e

marrëdhënieve serbo-shqiptare. Dramaturgu kosovar Jeton Neziraj shkruan në mënyrë përkruese për jetën e aktorit të filmit Faruk Begolli, fokusuar midis Prishtinës dhe Beogradit dhe jo përshtatshmërinë në kampin nacionalist.

Fluiditeti: Shkrimtarët me një identitet kombëtar të menjajuar shprehin shpirtin antinacionalist të së përditshmes. Poetesa shqiptare Gentjana Minga shkruan në italisht dhe i dërgon një përshëndetje poetike nënës së saj që banon në Durrës prej nga Bolzano. Ky lloj fluiditeti nuk është i ri: Albert Gjoka zbulon historinë e

tekstin.
Kanonet: Arian Leka mediton mbi përfshirjet dhe përjashtimet në raftet shqiptare të librave. Përvoja historike e Shqipërisë ka përfshirë izolimin ekstrem, por njëkohësisht ndjenjë e qëndrimit në qendër të stuhive geopolitike dhe ideologjike. Autori kujton 'xhaxhain e tij nga Rusia' teksta e mbushur me klasike të letërsisë ruse, me Atin e tij duke u përballur me këta libra nga Evropa Perëndimore. 'Lindja kundër Perëndimit! Letërsia perëndimore kundër asaj të Lindjes! Demokracitë e popujve të Lindjes kundër shkrimtarëve progresivë të Evropës! Jakobinët kundër zhironidëve letrare [...] por as xhaxhai im 'rus' as babai im nuk e kuptojnë absurditetin që i ndiqte të dy, shpjegon autori. 'Për të dy këto letërsi ishin rreptësisht brenda kufijve të tolerancës zyrtare. As edhe zhdukja e censurës nuk e ka realizuar vizionin Borgesian të parasësisë së një bibliotekë në vetvete.

Sonnenschein

→ Vizion nga faqja 19

quajnë nënën e tyre Mutti, bërte Traudi Schneider dhe më pickon nga faqet, por unë s'kam mundur t'i them Mutti, nuk kam mundur ta shqiptoj këtë fjalë Mutti, dhe atëherë vetë Traudi Schneider më tha, vetëm ta dish, se kam qenë roja më e ashpër, më tha, i kam rrahur njerëzit e kampit derisa ato të pesh-tynin gjak, tha, pastaj drejtoi trupin, rrëfen Helga, dhe nisi të përshkruante llahtarin e eksperimenteve mjekësore dhe më tha, natyrisht që kam qenë "për zgjidhjen përfundimtare", çfarë mendon se atje isha me pushime? dhe atëherë më ka thënë se në dhomat e gazit nuk vdisnin menjëherë, bebet vdisnin menjëherë, kemi tërhequr jashtë fëmijët e bërë mavi dhe kufomat dhe kur ndonjëherë qëllonte që në krematoriet s'kishte vend, u qëllonim në kokë

njerëzve, ndonjëherë do t'i vendosnim në rresht hebrejntë mu në zgrip të një grope të madhe dhe i qëllonim dhe ata binin të gjithë burra dhe gra dhe fëmijë në krahë të nënave të tyre, dhe unë kam qëlluar, natyrisht që kam qëlluar, isha qitëse e shkëlqyer, rrëfen Traudi Schneider duke buzëqeshur, oh Schöne Zeiten, thotë, rrëfen Helga, dhe njëherë, i thotë Traudi, dy kurva hebreje po ziheshin për një copë bukë, dhe ne i pikasëm, i kontrollonim për të gjitha këto kurvat, dhe i kemi nxjerrë ato për t'i qëlluar, natyrisht lakuriq dhe plot plagë, me vrage të hapura ngado, sepse para kësaj kishin shërbyer për katërmëdhjetë ditë në qelitë e dënimit në errësirë, me minjtë e shëndoshë si të ishin mace që ishin ushqyer me to, gati i kanë ngrënë ato të gjalla, kjo ishte arsyeja pse ishin me plagë dhe kur i kemi nxjerrë jashtë, ishin çmen-

dur nga tmerrri dhe mezi prisnin sa të merrnin plumbin në qafë, sa i urreja këto hebrejtë e mallkuara, uhh! Racë e tmerrshme, racë e ndyrë, më beso mua, puh, dhe atëherë unë i them asaj, rrëfen Helga, i them asaj, mos flit më tepër, e kam lexuar dosjen tënde, të gjithë këto i di, mos më shumë, dhe shkoj, kthehem në Bolonjë.

Pata makthe të tmerrshme dhe zemra më rrihte sikur do të kërcente dhe Traudi Schneider me pistoletë në duar bërte, më lër të iki! Do të të qëlloj nëse nuk do të më lëshosh, do të të vras nëse nuk më lëshon! Dhe atëherë kam marrë mjekime dhe tashmë zemra më rreh aq ngadalë, sa që më duket sikur të kem vdekur.

***Autorja ndërroi jetë një muaj më parë dhe ka bashkëpunuar me përkthyesin për librin e saj. Përkthet nga origjinali kroatisht Ben Andoni**



P

POEZIA

Fati yt...

Autori ka shkëputur tri poezi nga korpusi i vet, njëra prej të cilave është në anglisht

NGA ILIR KALEMAJ

I trishtë fati yt
I trishtë fati yt,
si karafillet që i ka ikur era qyshkur,
apo një moçalishte në një ditë shirash vjeshtakë,
ndoshta një pelikan krahëthyer në përpjekje për t'iu larguar shtrëngatës së fundit.

I trishtë fati yt,
endesh si Uliksi në kërkim të një itake që nuk ekziston,
përtej ëndrrave,
në truallin e thatë ku shpresa nuk lind,
ku imaginata ka firuar dhe jeta të harron.

I trishtë fati juaj,
fëmijë pa etër,
emigrantë me atdhe që e mohoni,
njerëz pa hije mbi dhe.

Ferri janë të tjerët,
apo thesht purgatori gjumë-prishës brenda nesh,
të gjesht parajsën e humbur të Miltonit,
apo të mbash përjetësinë pa t'ikur mes gishtash.
Një nga dilemat e shumëfishta të ekzistencializmit pa ekzistencë të njeriut-avator.

Universe

A concert of lights,
in open skies,
it liberates one's soul
from shackles of everyday boredom,



let me wander,
toward a multitude of wind perfumes,
realizing the endless boundaries of life.

Sitting by the Socratic fire,
meditating moments of happiness
in a sea of misery,
one wanders what's meaning of life
and gets lost by the sheer overwhelming sadness.

Transient passions
get lost through time,
Carpe diem
That loses its existential being,
through tunnels of time like Metamorphosis of Ovid,
while escaping in search of memory lost.

Like a post-modern Hades,
I end up in a rotten paradise.
And be awoken again like Phoenix of mythology
that flies away as a Pegasus,
to grasp the enigma of Universe.

Opinion *i* Ditës


5 vjet ekonomi e papërfillur

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... vendimmarrësve të forcave të majta politike në vend. Ndërsa, pas buxhetit të boshatisur të gjetur në shtator 2013, ministri i atëhershëm i Financave veprroi me maturi dhe me dorë të hekurit i disiplinoi dhe i shëndoshi gradualisht ato, e njëjta gjë nuk mund të thuhet me klimën e të bërit biznes tek ne. Ajo është bërë tej mase klienteliste dhe hipokrite. Katër vjet e gjysmë më parë, në 1 janar 2014, qeveria futi taksën progresive, duke rritur me 50 përqind tatimin mbi fitimin. Kjo ndikon drejtpërdrejt tek llogaritë për fitim të sipërmarrësve të huaj që duan të rrezikojnë kapitalin e tyre tek ne. Gazsjellësi TAP dhe hidrocentralet mbi lumin Devoll, dy investimet kryesore në ekonominë tonë në 5 vitet e fundit, ishin kontraktuar që në vitin 2009. Kemi 9 vjet pa ardhjen e një emri të njohur kompanie investimi.

Qeveria u kujtua shumë vonë për të ulur Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) në turizëm nga 20 në 6 përqind. Vetëm vitin e kaluar. Katër vite të shkuara kot! Kur sipërmarrësit e këtij sektori kishin 20 vjet që e kërkonin këtë ulje. Megjithatë, turizmi tek ne është rritur fort. Për pesë muajt janar-maj 2018, numri i të ardhurave nga jashtë sërish u rrit me 9 përqind, në krahasim me pesëmuajorin e parë të vitit 2017. Duke parë dendësimin e grupeve turistike në qendrat e qyteteve tona në qershor dhe dy javët e para të korrikut, ky numër mund të shkojë edhe me 15 përqind i rritur në fund të vitit. Përkthyer në para, mund të jenë 1.5 miliardë euro prurje nga turizmi, ose 150 milionë më tepër se një vit më parë. Por, kjo rritje nuk gëzon shumë, pse është spontane. Qeveria duhej të kishte ndërhyrë në turizëm, jo thjesht me kuadrin rregullator (për të cilin u kujtua shumë vonë), por me kujdesin prej saj për paketat turistike të propozuara nga bashkitë turistike. Nuk e ka bërë në këto 5 vite.



Po të kishte punuar si duhet, numri i të punësuarve në sektorin e turizmit sot tek ne nuk do të ishte rritur me vetëm 8 mijë, por ndoshta edhe 40 mijë vetë! Kjo do të ishte pasojë e vërtetë pozitive për familjet e varfra shqiptare

dhe jo deklaratat pompoze nëpër panairë pune se sektori privat ofron kaç apo aq mijë vende të reja, sikur këto vende qeveria t'i ketë rritur në inkubatorë të saj! 80 përqind e atyre vendeve të punës nuk janë për të varfrit keq

të arsimuar. Turizmi punëson lehtë në aktivitet turistik në fshat, apo në bregdet. Por për punën përgatitore për këto aktivitete, sidomos për turizmin bregdetar, qeveria qendrore dhe bashkitë kujtohen vetëm në maj, në ditë e përirimit

të sezonit turistik veror të "x" apo "y" qyteti. Kjo është papërgjegjshmëri e plotë. Sektori i eksporteve, me rënien e euros në tregun e brendshëm në 8 muajt e fundit është në vështirësi të madhe, por nuk ka asnjë paketë masash të përkohshme lehtësuese nga qeveria.

E njëjta gjë për sektorin e prodhuesve me material porositi-si (fasonistët), që punësojnë 60 mijë vetë e kanë potencial ta dyfishojnë këtë punësim, nëse taksa e fitimit u zerohet për një periudhë pesëvjeçare. Përfillja e vërtetë e ekonomisë së vendit ndodh kur ndihmon sektorët më premtues të tij të rrisin kapitalin dhe punësimin. Kjo nuk ka ndodhur në këto pesë vjet dhe qeveria duhet të mendohet mirë pse nuk e ka bërë. Ndoshta duhet ndryshuar diçka në boshitin e mendimit ekonomik të saj. Nëse vërtet shqiptarët janë lehtësuar nga taksat, sikurse butaforia qeveritare e jona nuk lodhet së hedhuri shifra dhe pluhur vezullues deformimi, atëherë përse nuk është rritur konsumi?

Lehtësimi nga taksat ose duhet të shkojë në rritje depozitash (kursimesh), ose në konsum të rritur. Dhe rritja e konsumit është baza për një ekonomi, që të prodhojë vende të reja pune. Kjo nuk ka ndodhur dhe është aktakuza më e fortë për shpërfilljen totale të ekonomisë reale të shqiptarëve, në këmbim të ngritjes së një velloje pseudo-suksesesh në ekonomi. Hiq 97 milionë dollarët e një lobimi politik kryeministrot për aeroportin e Vlorës, nuk kemi asgjë konkrete nga investimet e huaja të rëndësishme. Ato pritet të tkurren me rreth 20 përqind (parashikim i Bankës Botërore) për vitet 2019-2020 dhe ky është lajm jo i mirë për ekonominë tonë. Edhe kompensimin me ndërhyrjet në turizëm dhe në eksportet bujqësore nuk po e programojmë dhe ta realizojmë si duhet mbi një plan konkret të paktën 5-vjeçar. Dhe kjo është sërish, papërgjegjshmëri në katror, në planifikim shpenzimesh buxhetore për të zhvilluar ekonominë dhe në ndihmën e mangët dhe mungesën e koordinimit me bashkitë.

BalkanWebJ.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NË
MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE
DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



Dje në "Deutsche Welle"

Negociatat me BE? Shqipëria ka një detyrë të re përpara

Nga Ani Ruci

(vijon nga faqja 1)

... e pranimit në BE: përfundimi i reformave, zgjidhja e mosmarrëveshjeve me Greqinë, mbyllja e rrugës së re të emigracionit ilegal drejt Shqipërisë. Koha nuk pret për të dyja palët, Shqipërinë dhe BE. Në këtë kontekst, të premtën, (13.07.2018), Presidenti i Këshillit Europian, Donald Tusk dhe Komisioneri i Zgjerimit, Johannes Hahn zhvilluan takime në Bruksel me kryeministrin Rama, ku vunë pikat mbi "i" për fillimin e punës një orë e më parë.

Në një njoftim për shtyp nga Kryeministria në Tiranë, presidenti Tusk citohet të ketë thënë në një konferencë të përbashkët shtypi me kryeministrin Rama: "Nuk kam dyshime që, nëse Shqipëria do të vazhdojë me këtë temp reformash, do të jetë në gjendje që të arrijë të gjitha rezultatet e kërkuara deri në qershorin e ardhshëm. Përpjekjet e Shqipërisë për të sheshuar divergjencat me Greqinë janë prova më e mirë për angazhimin e saj ndaj BE-së dhe ndaj marrëdhënieve të mira fqinjësore. Kemi rënë dakord për rritjen e përpjekjeve lidhur me mbylljen e rrugës së re të emigracionit ilegal në Shqipëri".

TUSK: SHQIPËRIA, MIK I BE-SË NË LIDHJE ME SIGURINË E MIGRACIONIN

Shqipëria është vlerësuar për qëndrimin e saj ndaj çështjes së nxehtë të refugjatëve nga vendet e Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut drejt BE. Në vijim të këtij vlerësimi, Brukseli ka shtuar një kusht për Shqipërinë: mbylljen e rrugës së re të emigracionit ilegal nga këto vende në Shqipëri për të synuar më pas BE. "Shqipëria mbetet një partner i mirë dhe një mik i BE-së në lidhje me sigurinë e migracionin, ku kemi një bashkëpunim të fuqishëm dhe të qëndrueshëm. Sot koha e limituar dhe situata politike në vend janë 2 sfidat kryesore që Shqipëria duhet të përballojë që të ketë sukses në qershor 2019. Opozita e quan qeverinë Rama "qeveri të drogës dhe narko-trafikut" dhe kërkon rrëzimin e saj. Presidenti Tusk thekson përsëri mesazhin e njohur të BE-së që palët duhet të bëhen bashkë për çështje me rëndësi kombëtare, si hyrja e Shqipërisë në BE, që përkrahet nga mbi 90% e shqiptarëve. Ai citohet të ketë thënë të shtunën se është shpresa dhe dëshira e tij që "të gjitha forcat politike pro-perëndimore në Shqipëri të punojnë drejt të njëjtit qëllim".

HAHN: KE FILLON SË SHPEJTI "SCREENING" LIDHUR ME STADIN AKTUAL TË REFORMAVE NË SHQIPËRI

Puna përgatitore për hapjen e negociatave nuk kërkon vetëm



bashkëpunimin e forcave politike pro-perëndimore. Ajo presupozon një punë të madhe, gjithëpërfshirëse në aspektin teknik për të skanuar se çfarë është arritur dhe çfarë duhet arritur në të gjitha drejtimet që përfshihen në 35 kapitujt e hapjes së negociatave. Dhe këtu hyn në lojë shpejt, pa humbur kohë Komisioni Europian, (KE). "Do të mbërrij në Tiranë të enjten e ardhshme. Kemi rënë dakord që ekipet tona të fillojnë punën menjëherë, përpara pushimeve të verës, për të punuar në të gjitha drejtimet, që të garantohet

një analizë e qartë, e plotë mbi situatën", citohet të ketë thënë Komisioneri Hahn, në konferencën e përbashkët për shtyp me kryeministrin Rama në Bruksel. Pritshmëritë janë progresi në reformën në drejtësi, vazhdimi i vetingut, ngritja e institucioneve të reja të drejtësisë, në përputhje me reformën kushtetuese, të miratuar në mënyrë unanime nga parlamenti, dy vjet më parë, në korrik 2016. Pa lënë jashtë vëmendjes "luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në të gjitha nivelet, reduktimin e fenomenit të

azilkërkuesve shqiptarë në BE", theksoi komisioneri Hahn.

KËSHILLI I EUROPËS - PROGRES KUNDËR KORRUPSIONIT, POR ENDE SHUMË PËR TË BËRË

Shqipëria duhet t'i raportojë edhe Këshillit të Europës, nëse ia ka plotësuar apo jo rekomandimet e tij për luftën kundër korrupsionit. GRECO (Groupe d'Etats contre la corruption) - Grupi i shteteve kundër korrupsionit, një grup ndërqeveritar i ngritur nën kujdesin e Këshillit të Europës, për të parë në mënyrë kritike masat që anëtarët e tij marrin për të luftuar korrupsionin, në raportin e publikuar ditët e fundit pranon përparimin e Shqipërisë në zbatimin e rekomandimeve për të parandaluar korrupsionin tek parlamentarët, gjyqtarët dhe prokurorët. Por vëren se "duhen përfunduar reformat". Nga 10 rekomandimet të GRECO-s, Shqipëria ka plotësuar vetëm katër. GRECO u kërkon autoriteteve shqiptare që deri në 31 mars 2019 të japin një përditësim të progresit në zbatimin e 6 rekomandimeve të mbetura.

Shqipëria është vlerësuar për qëndrimin e saj ndaj çështjes së nxehtë të refugjatëve nga vendet e Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut drejt BE. Në vijim të këtij vlerësimi, Brukseli ka shtuar një kusht për Shqipërinë: mbylljen e rrugës së re të emigracionit ilegal nga këto vende në Shqipëri për të synuar më pas BE. "Shqipëria mbetet një partner i mirë dhe një mik i BE-së në lidhje me sigurinë e migracionin, ku kemi një bashkëpunim të fuqishëm dhe të qëndrueshëm.

HOROSKOPI

DASHI
Disa keqkuptime nga e shkuara do ju shqetësojnë disa ditë. Ruani qetësinë sepse është më mirë t'i mbyllni këto biseda sesa t'i shmangeni. Gjithçka do kohën e duhur, dhe pse do jetë pak e lodhshme. Kujdesuni më shumë për financat, pasi kohët e fundit po pësojnë disa lëkundje të ndjeshme.

DEMI
Një ditë e qetë pritet të jetë kjo e sotmja për të gjithë ju të lindurit në shenjtën e Demit. Kohën e lirë do preferoni ta kaloni në shtëpi, sepse keni nevojë të çlodheni pas një jave shumë të ngarkuar. Përkushtojuni familjes dhe do e ndjeni veten të realizuar në qëllimet tuaja.

BINJAKET
E diela do ju gjejë duke u marrë me përgatitjet e një darke miqësore të planifikuar prej kohësh. Detajet janë dobësisht ujat dhe do kujdeseni që gjithçka të jetë perfekte. Do merrni komplimente për punën tuaj dhe do ndiheni të vlerësuar.

GAFORJA
Nuk do jeni në humor shumë të mirë sot ju të lindurit në pjesën e parë të muajit. Disa shaka nga të afërmit nuk do priten mirë dhe do mbani distancë, e cila do vihet re nga të gjithë. Por kjo gjendje nuk do zgjasë shumë. Buzëqeshja do ju rikthehet shumë shpejt, me kthimin e Hënës në shenjtën tuaj.

LUANI
Yjet janë në favorin tuaj sot. Komunikimi dhe vendosmëria do të jenë pikat tuaja më të forta. Gjithçka që keni më mendje do ta thoni dhe shumë nga planet në vijim do ecin siç ju kërkoni. Ruani vendin tuaj dhe tregoni më shumë kujdes me financat.

VIRGJERESHA
Falë punës së palodhur, prestigji juaj sa vjen e rritet. Sigurisht që jo të gjithëve u pëlqen kjo gjë, dhe shpesh gjendeni në disa vështirësi. Qetësia dhe dashamirësia juaj reflektohen kudo, dhe ia dlini t'i kaloni pa shumë shqetësim këto pengesa. Dini të heshtni dhe të mos flisni vend e pa vend.

PESHORJA
Gjendja juaj emocionale do t'ju ndihmojë shumë t'i riktheheni ekuilibrit tuaj. Disa paqartësi që keni pasur kohët e fundit do të zbehen çdo ditë e më shumë, dhe kjo do reflektojë një ndryshim të ju. Partnerin do ta keni kra për çdo gjë, por tregohuni pak të matur me financat, sepse shpenzimet do jenë të shumta.

AKREPI
Disa rrethana shpesh bëhen shkak për ndryshime të mëdha dhe pikërisht kjo do ndodhë me ju sot. Përqijuni të përfilloni sa më shumë nga ofertat e ndryshme që do ju vijnë dhe merrni kohën e duhur për të vendosur. Ndonjëherë nuk ka kthim pas për zgjedhjet e nxitura. Tregohuni të vëmendshëm.

SHIGJETARI
Optimizmi dhe entuziazmi do jenë shoqëruerit tuaj më të mirë sot. Lodhja e gjithë këtyre ditëve do finalizohet me një mërmëje të bukur falë personave shumë të dashur. Gjithë energjia juaj do reflektohet përbalë dhuratave që janë përgatitur enkas për ju.

BRICJAPI
Hëna në shenjtën tuaj sot nuk do jetë shumë favorizuese. Do shfaqni një lodhje dhe një mërzitje që vetëm ju do ta kuptoni pse e keni. Të qëndruarit vetëm do t'ju ndihmojë, sepse keni nevojë të vini në rregull të gjitha idetë dhe planet për të ardhmen. Kur ta ndjeni veten gati, shprehuni dhe të jërvë shqetësimet tuaja.

UJORI
Sot është dita juaj. Shkathtësia në punë do vihet re nga të gjithë, por jo të gjithëve do t'u pëlqejë kjo gjë. Jeni ju që duhet të bindni të tjerët që gjithçka bëni tregon guximin dhe vendosmërinë tuaj. Qëndroni larg disa debatare dhe do jeni më të qetë. Është koha të tregoni vlerat tuaja.

PESHQIT
Dëshira juaj për një udhëtim mund të realizohet shumë shpejt, sepse falë punës së palodhur edhe të ardhurat janë disi më të kënaqshme. Flisni me partnerin tuaj për gjithçka dhe çdo gjë do shkojë më së miri.

